Gazeta Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XXIV i botimit, nr. 273, Korrik 2026

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër, Tel. +355685000229, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Klodjana Serraj, Çmimi 100 lekë / 1 euro

Zjarret e përgjakura të luftës Malazeze në Dukagjin, në muajin qershor - korrik 1915

Viti 1915 ishte ndër vitet ma të errëta, ma të trazueme dhe ma të përgjakshme në historinë e Shqipnisë, se sapo shpallun të pavarun. Shteti shqiptar ende nuk kishte arritë me u ngritë mbi themele të qëndrueshme, ndërsa Lufta e Parë Botnore e kishte shndërrue vendin në një fushë përplasjesh ushtarake e interesash gjeopolitike. Ishte një kohë kur shteti shqiptar, i shpallun vetëm pak vjet ma parë, ende nuk kishte muitë me u ngritë mbi kambët e veta. Institucionet ishin të brishta, pushteti i copëzuem dh[illegible]ë e vendit ishin shndërrue në fushë lakmish ...

2

At Shtjefën Gjeçovi, martiri dhe shërbestari...

Nga Albert Vataj

Më 12 korrik 1874, në Janjevë të Kosovës (vetëm 11 km larg Prishtinës), leu At Shtjefën Gjeçovi, një ndër gurthemelet më të njëmendta të vetëdijes sonë kombëtare. Ai dha një kontribut të vyer jo vetëm si klerik i devotshëm, por edhe si veprimtar i pasionuar i vlerave shpirtërore të shqiptarëve, duke u bërë dëshmitar dhe afirmues i asaj pasurie që mbart në vetvete tharmin e ekzistencës së këtij populli.

Ndonëse shpesh e lidhim kryesisht me monumentalizimin e "Kanunit të Lekë Dukagjinit", i cili doli në dritë si vepër e plotë në vitin 1933, katër vite pas pushkatimit të tij nga pushtuesi serb, më 14 tetor 1929 në Zym të Hasit, lëmi i shërbestarisë së Gjeçovit shtrihet shumë më gjerë, duke u kthyer në një vlerë të pamohueshme të kulturës sonë.

"Pulti kujton e promovon" - Përkujtimorja e Qereshit 2026

4

Me datën 15 korrik 2026, në Gjuraj të Planit u organizua veprimtaria e përvitshëm që bashkon kujtesën historike me promovimin e pasurive kulturore, natyrore dhe produkteve tradicionale të Pultit. Përkujtimorja e Qereshit, që tashme ka marre pagëzimin Festa e Qereshit, festohet që prej vitit 1940. Çdo 15 korrik banorët e kësaj krahine dhe kryesisht të fshatit Plan - Gjuraj mblidhen për të ruajtur një traditë të çmuar, e cila vitet e fundit mbështetet edhe nga Bashkia Shkodër. Ndoshta dikush pyet: Pse pikërisht më 15 korrik, edhe kur kjo datë nuk përkon me fundjavën? Sepse kjo është dita kur banorët e jo vetëm, përkujtojnë një nga ngjarjet më të rëndësishme të historisë së Pultit: 111-vjetorin e Qëndresës së Planit dhe në përgjithësi të gjithë Dukagjinit kundër pushtuesve serbo-malazezë.

Qëndresa Popullore e Kodrës së Palçit dhe Qafës së Agrit kundër ekspeditës ndëshkimore të Turgut Pashës, korrik 1910

6

Pas qëndresës heroike të luftëtarëve të Kosovës të udhëhequr nga Idriz Seferi, Isa Boletini dhe Hasan Hysen Budakova në Kaçanik, Caralevë e Budakovë, në prill 1910, kundër forcave të ushtrisë osmane, këto të fundit, me 12 qershor 1910, filluan operacionin në perëndim të Rrafshit të Dukagjinit. Duke pas parasysh qëndresën e fortë që Malësia e Gjakovës i kish bërë një vit më parë ekspeditës së Xhavit Pashës në Qafën e Morinës, në krye të divizionit të dytë, që do të sulmonte Malësinë u vu vetë gjenerali më i shquar turk Shefqet Turgut Pasha, i cili u nis nga Gjakova për t'i ra Malësisë. Plani i komandës xhonturke ishte, që operacioni të kryhej në drejtim të Qafës së Morinës–Qafës së Kolçit–Qafës së Agrit–drejt Shkodrës, ku do të vepronin 18 batalione këmbësorie dhe disa skuadrone kavalerie të përforcuara me bateri artilerie. Ndërkohë, rreth 2000 malësorë nga Gashi e Krasniqja të mobilizuar nën kushtrimin tradicional dhe të prirë nga prijësit e njohur popullor Zeqir Halili, Sadri Bardhi, Halil Brahimi, Abdulla Hoxha e të tjerë. zun pritat në frontin e Qafës së Morinës për të mos lejuar ushtrinë turke të hynte në Malësi. Turgut Pasha, ashtu si paraardhësi i tij Xhavit Pasha, përdori metodat më të egra çnjerëzore për të nënshtruar vendin. Përveç qindra goditjeve me artileri, ai dogji e shkatërroi pothuaj të gjitha shtëpitë e krahinës së Gashit.

cmyk

Zjarret e përgjakura të luftës Malazeze në Dukagjin, në muajin qershor - korrik 1915

Studiuesi, poeti e publicisti
Prele Milani

Viti 1915 ishte ndër vitet ma të errëta, ma të trazueme dhe ma të përgjakshme në historinë e Shqipnisë, se sapo shpallun të pavarun. Shteti shqiptar ende nuk kishte arritë me u ngritë mbi themele të qëndrueshme, ndërsa Lufta e Parë Botnore e kishte shndërrue vendin në një fushë përplasjesh ushtarake e interesash gjeopolitike. Ishte një kohë kur shteti shqiptar, i shpallun vetëm pak vjet ma parë, ende nuk kishte mujtë me u ngritë mbi kambët e veta. Institucionet ishin të brishta, pushteti i copëzuem dhe kufijtë e vendit ishin shndërrue në fushë lakmish për fqinjët e fuqitë e mëdha të kohës.

Në shumë vise të Shqipnisë flamuri kuqezi nuk valonte ma. Përveç Shkodrës e disa krahinave të Veriut, në shumë qytete e krahina ai ishte zëvendësue nga flamuj të huej. Jehona e thirrjes osmane: "Padişah çok yaşa!" – "Rroftë Padishahu!" – vazhdonte ende me ushtue në Shqipninë e Mesme e deri pranë Shkodrës, si jehonë e një perandorie që kishte lanë gjurmë të thella në jetën politike, fetare e shoqnore të vendit. (Fletorja "Besa Shqiptare", nr. 16, 1915).

Jo pak njerëz, të lodhun nga kaosi e të zhgënjyem prej mungesës së një shteti funksional, e shihnin ende shpëtimin te rikthimi i autoritetit osman. Në anën tjetër, Shqipnia ishte kthye në një truall ku ushtritë e hueja lëviznin sipas interesave të veta. Në disa krahina kishin hy serbët, në të tjera malazezët; austriakët po përparonin nga veriu, italianët po shtriheshin përgjatë bregdetit, ndërsa grekët e francezët kërkonin secili pjesën e vet të ndikimit. Çdo ushtri sillej me logjikën e fitimtarit, ndërsa çdo fuqi synonte me shkëputë nga një copë të këtij vendi të lashtë, por fatkeqësisht ende të pambrojtun.

Në atë vorbull lufte, përçarjesh e interesash ndërkombëtare, një pjesë e opinionit mysliman me prirje pro-osmane vazhdonte me besue se e ardhmja e Shqipnisë lidhej me Perandorinë Osmane, ndërsa patriotët shqiptarë përpiqeshin me çdo kusht me ruajte pavarësinë e sapofitueme dhe mos me lejue copëtimin përfundimtar të vendit.

Pikërisht në këtë sfond të errët historik zhvillohen edhe ngjarjet tragjike të Dukagjinit. Malet, që prej shekujsh kishin qenë mburojë e lirisë shqiptare, do të përballeshin me një tjetër stuhi pushtimi. Zjarri i luftës, djegiet, grabitjet, përplasjet dhe sakrificat e banorëve do ta shndërronin Dukagjinin në njanën prej skenave ma të dhimbshme të atij viti të mallkuem.

Aty, ku deri dje dëgjoheshin kambanat e bagëtive dhe lahuta e kullave, tashti do të jehojnë krismat e pushkëve, britmat e ushtarëve dhe flakët që përpijnë shtëpi, ara e jetë njerëzish. Në këtë hyrje kemi paraqitë vetëm panoramën e përgjithshme të vitit 1915.

Ngjarjet që lidhen drejtpërdrejt me qershorin dhe korrikun e vitit 1915 në Dukagjin, me hyrjen e ushtrisë malazeze, qëndresën e banorëve dhe dramën që përjetuen malësorët, do të trajtohen ma poshtë.

Hyrja me dredhi dhe perzania e malezezeve ne Shale, 17 qershor 1915

Sipas njoftimit të botuem në fletoren "Populli", më 17 qershor 1915, ushtria malazeze përdori jo vetëm forcën ushtarake, por edhe dredhinë për me depërtue në zemër të Dukagjinit. Me vete kishte marrë Fratin e Pejës, Fratin e Gjakovës, si edhe parinë e këtyne qyteteve, bashkë me krerët e Krasniqes, deri në kufijtë me Shalën. Prania e tyne nuk ishte e rastësishme. Ata u përdorën si ndërmjetës dhe si garanci morale për me i hapë rrugën forcave pushtuese drejt trevës së Shalës. Në vijim, ushtria malazeze thirri në takim Kryeparikun e Shalës, gjoja për bisedime. Mirëpo, sapo ai mbërriti në vendin e caktuem, i shoqëruem nga shokët e vet, u përball me një skenë krejt tjetër prej asaj që pritej. Një forcë prej ma shumë se një mijë ushtarësh malazezë e rrethoi menjëherë, tue ua drejtue bajonetat në gjoks. Nën kërcënimin e armëve, malazezët kërkuan një garanci të prerë: që mbi ushtrinë e tyne të mos kërciste asnjë pushkë. Përndryshe, paralajmëruen se Kryepariku me shoqëruesit e tij do të vriteshin në vend dhe më pas gjithë krahina do të digjej flakë e zjarr, me urdhën të komandës ushtarake. Kështu, tue përdorë mashtrimin dhe pengmarrjen si mjet presioni, ushtria malazeze arriti me hy në Shalë. Për arsye sigurie, ajo ngriti kampin në Logun e Kishës së Shalës, tue mendue se tashma e kishte nën kontroll krejt situatën. Por malësorët nuk vonuen me u përgjigje. Sapo ra muzgu, Delmeria lëshoi kushtrimin. Thirrja u përhap shpejt prej lagjeje në lagje e prej maje në majë dhe burrat e armatosun zunë vendet e tyne. Brenda pak kohe, forcat malazeze u gjendën të rrethueme prej të gjitha anëve. Kur e panë veten në një pozitë tepër të vështirë, malazezët ndryshuen qëndrim. Ata deklaruen se nuk kishin asnjë të keqe me Dukagjinin, por kërkuan vetëm t'u lirohej rruga për me kalue. Pas kuvendit me krerët e vet, edhe Djelmia pranoi me ua hapë udhën. Ushtria malazeze u lejue me u largue, tue shmangë kështu një përplasje që mund të sillte pasoja të randa për popullsinë vendëse. Sipas të njëjtit burim, malazezët ishin të pajisun me mitraloza, mortaja malore dhe shoqënoheshin nga shumë lopë të grabituna në viset që kishin pushtue gjatë marshimit të tyne. (Fletorja "Populli", 19.06.1915).

Veshoviqi, në Dukagjin turpërohet, (5 korrik 1915)

Në verën e vitit 1915, hija e luftës po zbriste gjithnjë e ma thellë mbi veriun shqiptar. Ushtria malazeze nuk lëvizte vetëm me forcën e armëve; ajo ecte edhe me hartat e përgatituna, me mashtrimin dhe me fjalën e dhanë, që shpesh thyhej sapo i shërbente qëllimit. Një krah i ushtrisë malazeze u derdh si ortek te Ura e Bunës, ndërsa një tjetër kaloi nëpër Shkrel, mbërriti te Ura e Mesit dhe u shtri deri te Penda e Kirit, fare pranë Shkodrës. Ishte një lëvizje e mendueme me kujdes, që synonte me e shtrëngue qytetin nga të gjitha anët. Në krye të kësaj force qëndronte gjenerali Vladomir Veshoviq. Pasi mbërriti te Ura e Mesit, ai ndali në krye të Shtojit, tue pritë çastin e volitshëm për me hy në Shkodër. Ndërkaq, në heshtje, kishte përgatitë një tjetër goditje: një forcë prej rreth një mijë e dyqind ushtarësh, e caktueme për me hy në zemër të Dukagjinit. Krerët e Dukagjinit, të vetëdijshëm për rrezikun, shkuan me e takue gjeneralin. Pas bisedimeve u lidh një besë: ushtria malazeze nuk do të hynte në Dukagjin derisa të merreshin vesh me Krajl Nikollën. Për këtë qëllim u nis për në Cetinë një delegacion i përbamë nga Mehmet Shpendi, Çun Nika, Marash Delia dhe Dedë Lulashi, ndërsa krerët e tjerë u kthyen në viset e tyne, tue besue se fjala e dhanë do të respektohej. Por lufta nuk e njeh gjithmonë nderin e burrave. Veshoviqi e përdori besën si mjet lufte. Ai e tërhoqi ushtrinë nga Ura e Mesit, e zhvendosi në Rrjoll dhe, përmes Qafës së Beshkasit, e futi në Plan, ku, krejt papritmas, çarmatosi Pultin. Kur këtë e morën vesh bajraktari i Shalës, Lush Prela, dhe Prekë Gjeloshi i Nicajve, shkuan menjëherë në Plan për me u takue me komandën malazeze. Edhe kësaj here morën të njëjtën fjalë: se ushtria nuk do të bante asnjë lëvizje ushtarake pa u kthye delegacioni nga Cetina. Por edhe kjo besë doli e rreme. Sapo Kryetari i Shalës u kthye në vendin e vet, po atë natë ushtria, nën komandën e Kostandin Nikiçit, kaloi Qafën e Boshit, hyri fshehtas në Shalë dhe u vendos në qytezën e Dakajve. Me të zbardhun dita, banorët e Gimajve të prirë nga Avdi Kola dhe të Nënmavriqit, që kishin diktue lëvizjen e pabesë të ushtrisë, ngritën kushtrimin. Malet u drodhën. Potera, britma, ulërima e krisma pushkësh u përzien me jehonën e shkëmbinjve. Brenda pak çastesh u ngrit në kambë krejt Shala..." Haljanet dhe Malazezët u ndeshën si dy rrufe" . Burra, pleq e djelmosha zunë shtigjet e malit, ndërsa lajmi u përhap ma shpejt se era. Madje pati edhe vendas që u folën ushtarëve malazezë në gjuhën slave, tue ua kujtue se ndodheshin në një vend ku nuk kishin shpëtim dhe se, sado e madhe të ishte ushtria e tyne, malet nuk do t'i falnin. Përballë një terreni krejt të panjohun, mes grykash të ngushta, shkëmbinjsh thikë dhe humnerash të frikshme, paniku pushtoi krejt kolonën ushtarake. Ata nuk dinin nga t'u vinte goditja. Çdo lis u dukej pushkë, çdo shkëmb pritë, çdo jehonë një ushtri e fshehun. Aty fitoi ma shumë dredhia e malësorëve sesa forca e armëve. Shumica e burrave të Shalës kishin vetëm nga një pushkë të vjetër e pak fishekë, ndërsa disa nuk kishin fare armë. Megjithatë, guximi, njohja e terrenit dhe lufta psikologjike banë atë që nuk do ta kishin ba dot as topat. E gjithë armata malazeze, rreth 1.200 ushtarë, hodhi armët përdhe dhe u dorëzua. Thuhet se komandanti Kostandin Nikiçi, kur e kuptoi se kishte ra në kurthin e malësorëve, u trondit aq randë sa "iu nxi drita e diellit", i pushtuem nga turpi i një dorëzimi që nuk e kishte mendue kurrë. Malësorët morën armët, siç e kërkonte zakoni i luftës. Ushtarët e dorëzuem u kaluen nën armë, sipas riteve të kohës, por nuk u keqtrajtuen. Përkundrazi, mbasi u çarmatosën, u përcollën të sigurt drejt Qafës së Pejës , me rrugë për në Guci, tue dëshmue edhe një herë se në malet e Dukagjinit, edhe në fitore, nderi qëndronte mbi hakmarrjen.

Lufta në Curraj, me 4 – 5 korrik dhe në Qafen e Kolshit me 9 korrik 1915

Pa u shue ende jehona e asaj beteje, e pa u tretë tymi i barotit mbi kreshtat e Dukagjinit, Shala, Shoshi e Toplana u gjendën përballë një rremi tjetër të ushtrisë malazeze. Mali i Zi kishte lëshue një forcë të re prej Gjakove, e cila, tue kalue nëpër Gash, Krasniqe, Nikaj e Mërtur, përpiqej me ua marrë armët malësorëve, me nënshtrua ato krahina e mandej me depërtue drejt Pellgut të Dukagjinit e, prej andej, në Shkodër. Burimet e shtypit të kohës dëshmojnë se, prej armëve të zana ushtrisë malazeze, Shala u tregua bujare edhe me Shoshin e Pultin, tue i pajisë me pushkë e municion e tue ua shtue edhe ma fort zemrën e guximin. Kështu, malësorët e këtyne viseve luftuen krah për krah me Nikajt, si një trup i vetëm, të bashkuem jo vetëm prej armës, por edhe prej besës e fatit të përbashkët.

Në qendër të kësaj qëndrese qëndronte At Çiril Cani, famullitari historik i Shalës, i cili nuk u mjaftue vetëm me fjalën e altarit. Ai u ba një prej frymëzuesve ma të mëdhenj të qëndresës popullore antimalazeze, tue e mbajtë ndezë deri në fund fitilin e kryengritjes, me urti, me guxim e me besim se liria nuk lypej, por mbrohej. Ndërkaq, në Curraj të Epërm, At Leonard Shkjau u ra malazezëve pas shpine me një lëvizje të guximshme e të mendueme mire. Bashkë me burrat e Palçit dhe me At Benardin Llupin, ai i ngriti banorët në kambë. Kush kishte pushkë, mori pushkën; kush nuk kishte, doli me çka i ra në dorë. Të gjithë u banë një trup i vetëm. Sulmi i tyne i befasishëm e

I furishëm i detyroi malazezët me u zmbrapsë deri në Qafën e Kolshit. Në Curraj me 4 korik dhe ne Nikprendaj me 5 koriku ku sulmua dhe muar posta malazeze u shënue një ndër aktet ma të spikatuna të qëndresës popullore, një ngjarje që mbeti e pashlyeshme në kujtesën historike të Malësisë. Forcat e shumta malazeze u dëbuen me turp; trimnia e burrnia arritën kulmin e vet. Shpirti dhe mendja e kësaj qëndrese në Nikaj-Mërtur ishte njeriu i shenjtë, At Benardin Llupi. Ai vuni në shërbim të luftës një mitraloz, që Hysni Curri e kishte lanë ma herët në kishën e Mërturit, gjatë kthimit prej Durrësit, pas ngjarjeve të vitit 1914. Frati atdhetar kishte mësue rrogëtarin me e përdorë atë armë me mjeshtëri të rrallë. Mitralozi, tue shti me nishan e me ritëm të pandërpremë, shkaktoi humbje të mëdha në radhët e armikut. Por vlera e tij ma e madhe ishte taktike e psikologjike. Zhurma e pazakontë e breshnive dhe goditjet e sakta mbollën panik ndër malazezë.

Ata u bindën se përkrah malësorëve nuk luftonin vetëm bijtë e Dukagjinit, por edhe forca austro-hungareze, me të cilat Mali i Zi ndodhej në gjendje lufte. Ky besim i rremë ua theu zemrën e ua trandi vendosmërinë, duke e shpejtue tërheqjen e tyne nga Currajt e deri në Qafën e Kolshit.

Nikaj Merturi shpi për shpi dhe një çete trime nga Shala e Toplana e prirë nga Mark Sadiku i Pecajve zunë në Qafën e Kolshit u ndeshën ashpërsisht me ushtrinë me shumë frymëshe te Vladomir Veshoviqit. Me 9 korrik 1915 në Qafen e Kolshit do shkruhej një faqe e re historie e kësaj malësie. Kronikani, ideatori dhe organizatori kësaj qendërese, At Benardin Llupi shkruan: Gjate luftimeve u vranë një major tre kapitena dhe disa ushtare malazez; ndërsa 17 u banë tesmil (u zinë robër + 31 te të tjerë gjate ndjekjes që i benë forcave armike deri Geghysen).

Kjo degë e ushtrisë Malazeze do këputej në cung e nuk do ti bashkëngjitej degës tjetër ne Dukagjin dhe Shkodër dhe do të dilte sikur Isa Boletini të mbante premtimin sipas planit organizativ. Tërheqja e tij e korruptuar u hapi shtegun malazezve të hynin në Nikaj Mertur dhe prej andej në Dukagjin. -Isa Boletini me 70 vetë lëshoj ballin e luftës e mori ikën, ndërsa të tjerëve u hyni frika.

Tragjedia e Planit,
me 10 - 15 korrik 1915

Ka çaste në histori kur lufta nuk matet ma me fitore e humbje, por me peshën e lotit që mbetet mbi tokë. Ka beteja që nuk mbesin në kujtesë pse ndryshojnë kufijtë, por pse ndryshojnë fatin e një populli. E tillë ishte Tragjedia e Planit, një ndër faqet ma të dhimbshme të qëndresës së Dukagjinit, ku nderi luftoi deri në frymën e fundit, ndërsa barbaria kërkoi me e thye shpirtin e malësorit tue ia djegë votrën. Ndërsa në Nikaj-Mërtur, me ndihmën e Shalës e të Shoshit, vazhdonte gozhdimi i ushtrisë malazeze, një kushtrim tjetër përshkoi si vetima krejt malet: armiku kishte hy përsëri në Pult. Marrëveshjet e bamuna pak ditë ma parë u shkelën pa pikë turpi. Fjala e dhanun u ba hi para lakmisë pushtuese. Me urdhën të Veshoviqit dhe nën komandën e Marjan Pashës, më 10 korrik 1915, ushtria malazeze iu turr sërish Dukagjinit. Por kësaj here ajo nuk solli vetëm pushkë e topa, solli edhe një armë ma të ligë: pengjet. Krerët e Djelmnisë së Shalës, të kthyer prej Cetinës jo si njerëz të lirë, por si robër lufte, u përdorën si mjet presioni.

Ushtria donte me e pas Dukagjinin si veza në pëllambë të dorës. Çun Nika, Marsh Delia e Mehmet Shpendi mbaheshin nën rojë të rreptë. Vetëm Dedë Lulashi, ma i riu ndër ta, u lejue me u nisë drejt maleve për t'u çue malësorëve kushte të reja. Mesazhi ishte mizor: - "Po krisi një pushkë kundër Malit të Zi, këta burra nuk kanë me pa ma dritën e diellit. Hakmarrja ka me kenë e tmerrshme". Ishte çasti kur frika pritej me mposhtë burrninë. Por historia nuk mbahet mend për ata që u trembën. Ajo mbahet mend për ata që folën kur vdekja u rrinte mbi krye. Ashtu si dikur konsulli romak Marcus Atilius Regulus, që nuk e tradhtoi Romën edhe pse e dinte se po shkonte drejt torturës e vdekjes, edhe Mehmet Shpendi nuk pranoi me u ba zani i pushtuesit.

Ai ia ktheu Dedë Lulashit me një amanet që u ba betim për krejt Dukagjinin: "Thuaju Dukagjinit, mos u koritni! Mos i lëshoni armët! Për ne mos kini dert. Për gjakun tonë mos iu nënshtrohuni shkjaut". Në ato pak fjalë kishte ma shumë liri sesa në gjithë premtimet e armikut. Kur karvani i pengjeve mbërriti në Plan, amaneti kishte fluturue tashma prej maje në maje. Pushka e parë krisi. E me të krisi edhe dënimi. Hakmarrja ra menjëherë mbi pengjet. Të parët që ranë ndër shtatëdhjetë e nëntë martirët e asaj tragjedie qenë Mehmet Shpendi, Çun Nika e Marsh Delia. Ata nuk u vranë pse humbën një betejë. U vranë pse nuk pranuan me e ulë kryet.

Gjaku i tyne u ba kushtrim. Nga Shala, Shoshi, Toplana e Dushmani u ngritën çetat si lumenj që zbresin prej bjeshkëve. Nderkiza u shndërrue në një amfiteatër madhështor të qëndresës. Qafat u zunë një mbas një. Grykat u mbyllën. Çdo shteg u kthye në pritë. Për pak çaste dukej sikur historia po përsëritej. Ushtria malazeze, e rrethueme, në Plan ndodhej në prag të një katastrofe të ngjashme me atë të Dakajve. Por lufta nuk fitohet gjithmonë vetëm me trimni. Disa veprime të pakontrollueme, mungesa e një komande të përbashkët dhe, mbi të gjitha, ardhja e përforcimeve ndryshuen rrjedhën e ngjarjeve. Nga Shkodra u nis një brigadë e re malazeze, e përkrahun fatkeqësisht edhe prej forcash shqiptare nga Gruda, Triepshi e Kuçi, nën komandën e Mehill Spasit.

Ishte një nga ato plagë, që historia shqiptare i ka ndie ma randë se vetë armiku. Sepse kur shqiptari ngre armën kundër shqiptarit në shërbim të huajit, plagët nuk mbyllen me shekuj. Mehill Spasi doli në Qafë Thanë dhe nisi me e bombardue Pultin me një egërsi të papërmbajtun. Një tjetër re e zezë u derdh prej Cukalit e Gurit të Lekës. Topat rrahën Shoshin. Mitralozat çanin kreshtat. Malet, që deri dje jehonin nga kënga e barinjve, ushtonin tash prej bubullimës së hekurit.

At Justin Rrota, dëshmitar i kohës, shkruante me admirim: "Malësorët bajnë namin mbi ushtarët". Edhe ata që ishin largue pa dashakeqësi u kthyen përsëri në kushtrim. Askush nuk donte me mungue aty ku rrezikohej nderi i vendit. Kodra e Kujes, Bjeshka e Kufinit me Shalën, Pla të Madh, Maja e Lubinit, Qafa e Shtogut, Qafa e Boshit, secila qafë u ba një faqe e përgjakun e një epopeje. Përballë martinave shqiptare gjëmonin topat e mitralozat e një ushtrie moderne.

Përballë numrave qëndronte besa!

Përballë hekurit qëndronte zemra!

Malësorët shfrytëzuan çdo gur, çdo shkurre e çdo ledh. Fitoret e para ndezën shpresën, entuziazmin, por me kalimin e ditëve situata po vështirësohej, vullnetarëve municioni u pakësohej; ndërsa armiku përforcohej me forca te reja dhe me municion. Si në çdo luftë, pati edhe ndonjë të joshur nga paraja që informoj armikun per pikat e dobta, shteg kalimet dytësore apo ndonjë qëndrim të shkujdesur të forcave të fronit Dy luftëra të mëdha kishin herrë fuqinë e Dukagjinit. Mungonte armatimi, mungonte organizimi ushtarak. Ushtria malazeze pas disa ditëve shtange arriti te kapë pozitat dominuese dhe u fut në Plan, duke ushtruar një ciklon terrori të përgjakshëm, duke ndëshkuar me zjarr e me hekur dhe duke u hakmarrë mbi të gjitha moshat pa kursye as gra, fëmijë e as pleq. Një pjesë e forcave vullnetare u tërhoqën, duke vijuar qëndresën në mënyre dëshpërues Luftimet në Qafë të Boshit zgjatën deri në muzg. Ishte luftë burrash kundër një makinerie shtetërore. Në fund, jo pse u mposht trimnia, por pse u shterrën mundësitë, malësorët u detyruan me u tërheqë përtej Drinit, aty ku kishte mbërritë ushtria e Esat Pashës.

Kryengritësit mbetën ndërmjet dy zjarreve dhe atëherë filloi akti ma i zi i kësaj tragjedie. Me urdhën të Kostandin Nikiçit u dha sinjali me bori. Nuk ishte kushtrim për betejë. Ishte kushtrim për djegie. Shtëpive të Shalës e të Shoshit ua vunë flakën sistematikisht. Vatra që kishin ushqye breza të tërë u kthyen në hi. Stanet e Qafë Lisit u banë pika soditjeje të një ferri tokësor. Kush shikonte prej andej e shihte Shoshin të shtrimë poshtë si në pëllambë të dorës, por nuk dallonte ma çatitë. Vetëm trungje të nxira. Vetëm oxhaqe të rrëzuem. Vetëm tym. Balë Mark Milani dhe Gjon Marashi kujtonin se nga Rrethi i Brashtës hapej po ajo pamje e kobshme: krejt Shala dukej si një det shkrumbi, ku jeta kishte mbet vetëm në kujtim.

Kur ushtria malazeze u largue, la mbrapa një tokë të përgjakun. Tetedhjetë e një martirë në Pult. qindra shtëpitë e djegura gjithçka u plaçkit masivisht Fshatra të zbrazuna, kope të shfarosura, familje të shpërndame.

E megjithatë nuk arriti atë që kishte synue. Nuk e theu shpirtin e Dukagjinit, sepse shtëpia mund të digjet. Ara mund të mbetet djerrë. Kulla mund të rrënohet. Por një popull që jeton me besë, me nder e me kujtesë nuk pushtohet kurrë plotësisht. Prandaj Tragjedia e Planit nuk është vetëm historia e një disfate ushtarake. Është historia e një fitoreje morale, asht dëshmia se në verën e vitit 1915, mbi kreshtat e Pultit, Shalës e Shoshit, Nikaj Merturit, Toplanës, Temalit dhe Shllakut nuk u mbrojt vetëm një copë tokë. U mbrojt dinjiteti i një krahine e nji zone, që zgjodhi me u shkrumbue, por jo me u gjunjëzue.

Sfida e Gurit të Kuq, Dhjetor 1915

Ka ngjarje që historia nuk i hap rrugën vetëm në faqet e librave, por i gdhend në gur, në pyje, në përroje e në kujtesën e popullit.

Një ndër to asht edhe përleshja e Gurit të Kuq, ku natyra u ba aleatja ma besnike e malësorëve dhe ku trimnia u përplas me fuqinë e një ushtrie pushtuese.

Për disa kohë, Mali i Zi qëndroi nëpër Dukagjin si një kaçubet i mbjellun me forcë në tokë të huej. Dukej i plotfuqishëm, por kurrë nuk ishte as i qetë, as i sigurt. Çdo ditë përballej me goditjet e komiteteve të malit, që nuk i ndalnin sulmet dhe nuk e lanë pushtuesin me marrë frymë lirshëm.

Forcat malazeze ishin përqendruar kryesisht te Posta e Nicajve në Shosh, prej nga përpiqeshin me mbajt nën kontroll krahinën, ndërsa përleshjet me çetat e malësorëve vazhdonin pa ndërprerje. Lufta nuk kursente as jetën, as bukën. Nuk mbeti tufë bagëtish e as koshere bletësh pa u grabitë. Arat mbetën djerrë, të rrafshueme e të thanuna, sepse pushka ua kishte këputë vaditjen. Në bjeshkë nuk shihte ma syri kope tue kullotë, as ndihej ma za djelmoshash tue këndue. Heshtja kishte zaptue stanet. Nanat, të mbështjella me shamitë e zeza, vajtonin djelminë e humbun, ndërsa qyqet ndër lisa kukasnin si me dashtë me ia kujtue maleve tragjeditë që kishin pa me sytë e vet. Vera kaloi përmes flakëve e gjakut, e vendin e saj e zuni vjeshta e zymtë e mbushun me plagë që nuk shëroheshin. Çdo shtëpi kishte një mungesë, çdo vatër një dhembje. Ndërsa dimri afrohej me borë e ngrica të mëdha, ushtria malazeze e ndiente se toka nuk i pranonte ma. Frika se mos një brez i madh luftëtarësh ua priste rrugët e tërheqjes i detyroi me marrë vendimin me u largue.

Natën, pa zbardhë drita, filloi tërheqja. Por mali nuk flinte! Shoshjanët, që e kishin malin strehë, sy e vesh, e diktuen lëvizjen. Lajmi u përhap nga maja në majë me shpejtësinë e erës. Pushkët u kapën pa humbë kohë dhe burrat iu lëshuen armikut si rrufeja që zbret prej kreshtave. Sulmi qe i rrufeshëm, i menduem dhe shkatërrues. Në atë vend ku çdo shkamb e çdo shteg fliste gjuhën e malësorëve, ushtria malazeze u gjend e çoroditun. Terreni, që për vendasit ishte aleat, për pushtuesin u kthye në kurth. Vullnetarët e shoshit dhe Pultit e ndoqën armikun kambë për kambë, tue mos i lanë me marrë frymë, derisa kolonat e tij, të çrregullueme e të rraskapituna, u tërhoqën drejt Prekalit. Aty, në vendin që historia e njeh me emnin Guri i Kuq, mbetën të shtrime shumë ushtarë malazezë. Përplasja ishte aq e ashpër, sa në mesin e të plagosunve rëndë mbeti edhe komandanti i armatës, Mehill Spasi.

Emni i Gurit të Kuq mori kështu një kuptim të ri, sepse u ngjyros jo vetëm prej dheut të kuq të vendit, por edhe prej gjakut të derdhun në atë përballje të pamëshirshme. Hidhërimi për humbjet e randa e verboi ushtrinë malazeze. Në shenjë hakmarrjeje, ajo vendosi me ia vu flakën mbarë katundit të Prekalit. Rreziku i një shfarosjeje kolektive ishte i pashmangshëm. Por në atë çast kritik doli përpara një burrë i Zotit, që u ba mburojë e popullit të vet. Frati i Prekalit, At Ejll Vjerdha, me kryqin e bekuem në dorë, me fjalën që kishte peshën e shpatës dhe me urtinë që dinte me fashitë urrejtjen, hyri ndërmjet dy palëve. Ai nuk kishte armë tjetër veç besimit, por ajo armë doli ma e fortë se

"Pulti kujton e promovon" – Përkujtimorja e Qereshit 2026

Me datën 15 korrik 2026, në Gjuraj të Planit u organizua veprimtaria e përvitshëm që bashkon kujtesën historike me promovimin e pasurive kulturore, natyrore dhe produkteve tradicionale të Pultit.

Përkujtimorja e Qereshit, që tashme ka marre pagëzimin Festa e Qereshit, festohet që prej vitit 1940. Çdo 15 korrik banorët e kësaj krahine dhe kryesisht të fshatit Plan - Gjuraj mblidhen për të ruajtur një traditë të çmuar, e cila vitet e fundit mbështetet edhe nga Bashkia Shkodër.

Ndoshta dikush pyet: Pse pikërisht më 15 korrik, edhe kur kjo datë nuk përkon me fundjavën?

Sepse kjo është dita kur banorët e jo vetëm, përkujtojnë një nga ngjarjet më të rëndësishme të historisë së Pultit: 111-vjetorin e Qëndresës së Planit dhe në përgjithësi të gjithë Dukagjinit kundër pushtuesve serbo-malazezë.

Në korrikun e vitit 1915, kjo krahinë dha një shembull të rrallë trimërie. Rreth 81 luftëtarë u përballën me guxim me ushtrinë pushtuese, ndërsa afro 200 shtëpi u dogjën e u plaçkitën barbarisht. Sakrifica e tyre mbetet themeli mbi të cilin ndërtohet kujtesa jonë. Sot janë mbledhur pikërisht këtu, në fshatin Gjuraj, pranë Memorialit të Dëshmorëve të Planit dhe Dukagjinit, për të nderuar ata që dhanë jetën për lirinë e kësaj treve. Po kështu, të pranishmit kujtuan edhe dëshmorët e Qafë Thanës. Sivjet shënohet 81-vjetori i rënies së dhjetë martirëve, tetë prej të cilëve ishin bij të kësaj zone. Edhe fshati Xhan mban me krenari kujtimin e 14 dëshmorëve të tij. Historia e kësaj treve është e mbushur me akte heroizmi: sakrifica e Nik Çunit në Qafën e Mjegullës, e doktor Ndue Prelës në Theth, e Pllum Gjonit, e Gjergj Maçit, Mitër Keqit dhe shumë burrave të tjerë që zgjodhën lirinë përpara jetës. Këta emra janë pjesë e ndërgjegjes historike të Pultit.

Një popull që harron të kaluarën, rrezikon të humbasë të ardhmen. Prandaj, çdo 15 korrik përulemi me respekt para dëshmorëve tanë, për t'u kujtuar brezave se liria është fituar me gjak e sakrificë.

Lavdi e përjetshme dëshmorëve të Planit dhe të gjithë bijve të kësaj krahine!

Veprimtaria vijoi me vendosjen e kurorave pranë memorialit të dëshmorëve nga autoritete vendore, nga familjaret e dëshmorëve e përfaqësues të shoqatave të ndryshme.

Më pas u mbajtën fjalët e rastit në një ditë të tillë të shënuar.

Organizatorët justifikuan këtë vit paraqitjen e festës me elementet e saj të reduktuara, për shkak dhe të dhimbjes që shkaktoi te banorët humbja e jetës së një banori pak ditë më parë, duke u solidarizuar me familjarët e tij që po përjetojnë një moment shumë të vështirë.

Pulti – një thesar historie dhe natyre.

Pulti nuk është vetëm histori.

Ai është një nga trevat më të pasura të veriut shqiptar në trashëgimi, natyrë dhe traditë. Me 7 fshatra dhe mijëra banorë ndër breza, Pulti mbetet një nga zonat që, pavarësisht vështirësive, nuk është braktisur. Ka ende familje që jetojnë këtu gjatë gjithë vitit, duke ruajtur traditat, besimin dhe lidhjen me tokën. Kjo trevë ka qenë dikur qendra e Principatës së Pulatit të hershëm.

Nga këtu vjen edhe figura e shquar e At Gegë Lumajt, i nderuar me titullin "Nderi i Kombit".

Në Gjuraj janë zbuluar materiale minerare që lidhen me prodhimin e monedhave të hershme në Arbëri. Në Pult është derdhur edhe kambana e njohur 200-kilogramëshe e kishës, ndërsa mbi këto troje ngrihet edhe Kështjella mesjetare e Spanit. Këtu buron lumi Kir, një nga perlat natyrore të Shkodrës, i cili çdo vit tërheq gjithnjë e më shumë vizitorë.

Pulti numëron mbi 2 200 hektarë gështenja, pyje të pasura, shpella të rralla, shtigje alpine për ecje, produkte krejtësisht bio dhe një mikpritje, që mbetet vlera më e madhe e kësaj treve. Sot vizitorët mund të akomodohen në bujtinën "Bletaj", në kampingun "Lugina e Kirit", kampingun e Tom Nokës, e të tjera, apo të eksplorojnë bukuritë e shumta natyrore të zonës. Banorët e Pultit njihen për fisnikërinë, mençurinë dhe mikpritjen e tyre. Biseda me ta është një përvojë që nuk harrohet.

Megjithatë, kjo zonë vazhdon të përballet me sfida të mëdha: infrastruktura rrugore, shërbimet shëndetësore dhe shkollimi mbeten ndër problemet kryesore që kanë ndikuar në largimin e një pjese të banorëve. Falë kontributit të vetë banorëve dhe emigrantëve, u ndërtua rruga drejt Gjurajve dhe prej 2 vitesh u restaurua edhe kisha e Planit, dëshmi se dashuria për vendlindjen mbetet më e fortë se çdo vështirësi.

Sot, Festa e Qereshit nuk është vetëm një festë. Ajo është një ditë kujtese, bashkimi dhe shprese.

Programi artistik, panairi i produkteve tradicionale, promovimi i resurseve turistike dhe eksplorimi i natyrës janë pjesë e kësaj veprimtarie, që synon ta mbajë Pultin të gjallë dhe gjithnjë e më të njohur.

Në fund, një falënderim të veçantë për Bashkinë Shkodër, që mbështeti festën, banorët, emigrantët dhe të gjithë kontribuuesit ndër vite, veçanërisht familjet Suka, Gjinaj dhe Rrushaj, për mbështetjen e vazhdueshme!

Mirë të vini gjithmonë në Festën e Qereshit 2026!

Le ta kujtojmë historinë tonë me krenari dhe ta promovojmë Pultin siç e meriton.

Gazetarja
Kozeta Bruçi

---

shumë pushkë. Zani i tij preku edhe zemrat e disa malësorëve të Trieshit e të Grudës, që shërbenin në përbërje të asaj ushtrie. Ata u banë krah i ndërmjetësimit dhe ndihmuen me ndalë shkatërrimin.Kështu gjakrat u ulën. Flaka nuk u ndez. Prekali shpëtoi prej djegies dhe banorët e tij prej një tragjedie, që do të kishte lanë gjurmë edhe ma të randa në historinë e Dukagjinit. Kjo përballje nuk mbeti vetëm në kujtesën gojore të malësorëve. Ajo u dokumentue edhe nga autori i vëmendshëm At Zef Arapi, i cili shkruan me përgjegjësi historike se, përveç "krerëve të Djelmisë dhe fatosave të Planit, mbetën edhe 30 vetë të tjerë nga gjithë hapësira e Dukagjinit të Shkodrës".

Kjo dëshmi, e ruajtun në shkrimet Zef Arapit, Dukagjini në dokumente Historike, Pjesa I, f. 203, e vulos me autoritet sakrificën e atyne burrave, që ranë në mbrojtje të vendit të vet.

Pra, numri i te vrarave shkon 110.

Sfida e Gurit të Kuq nuk ishte veç vatra përmbyllëse e një viti tragjik, por ajo ishte ktarama e fundit dukagjinse e përplasjes mes pushtimit dhe lirisë, mes dhunës dhe dinjitetit njerëzor.

Kjo ndeshje e rrufeshme dëshmoi se fitoret nuk maten vetëm me armë, por edhe me shpëtimin e jetëve dhe të nderit të një populli!

Përkujtohen në Shkodër fatosat e lirisë, Çerçiz Topulli dhe Mustafa Qulli!

Me 17 korrik 1915 pushtuesit malazez në Shkodër vranë fatosat e lirisë, Çerçiz Topullin dhe Mustafa Qullin!

Ata kishin ardhur prej muajsh në Shkodër pasi përndiqeshin në Gjirokastër nga barbarët grekë! Ushtria malazeze e informuar për aktivitetin e tyre në mbrojtje të Jugut të Shqipërisë, i arrestoi ata dhe i ekzekutoi në orët e para të mëngjesit të 17 prillit 1915, në daljen veriore të qytetit të Shkodrës, fshati Dobraç!

111 vjetori i asaj dite të përgjakur nga gjaku i Çerçiz Topullit e Mustafa Qullit u përkujtua sot në Shkodër, ku tek memoriali përkujtimor u vendosën kurora me lule dhe u bënë homazhe.

Kujtomë se eshtrat e këtyre dy fatosave të lirisë u përcollën nga Shkodra për në Gjirokastër në prill të vitit 1936 nëpërmjet një ceremonie historike që ua kushtoi Shkodra!

Në vijim fjalimi që mbajti atë ditë At' Anton Harapi!

Fjalimi madhështor i At' Anton Harapit në ceremoninë e zhvilluar në Shkodër në prill të vitit 1936 për përcjellën në Gjirokastër të fatosave të lirisë - Dëshmorëve të Atdheut Çerçiz Topulli e Mustafa Qulli.

Në këtë ceremoni ka marrë pjesë dhe mbajti fjalën në emër të djelmnisë së Gjirokastrës edhe Enver Hoxha.

NGA AT ANTON HARAPI O.F.M. -Mbi Eshtën të deshmorve t' Atdheut Çerçiz Topulli e Mustafa Qulli, Ndalniu! Ku vén, o burra?!.. Çerçiz e Muço, dy fjalë ka me ju Shkodra kreshnike, këtu në log të kuvendit, para se të ndaheni. Doni t' a leni Shkodrën, të shkoni e të pushoni atje, ku së pari keni pa t' amblat rreze të diellit, ku, si filiza të shëndoshtë, gëzueshëm e rritët shtatin, atje prej kah Shqipnia u qiti edhe u ndriti! Lè të lavdohen, po, per ju Gjinokastra e Leskoviku, vendet ku ju u lindët për jetë, por grimë ma pak s'do të gëzohet me ju Shkodra, vendi, ku ju nuk vdiqët, por u lindët për Atdhé. Njimênd se ato u dhanë tamblin e gjiut, e u janë nana të natyrshme, por ju tashma, nuk jeni njerëz të zakonshëm, nuk jeni çfarëdo Shqiptarësh, ju jeni heroj, jeni burra Shqiptarë; e si të tillë u priti e ju mbajti, si të tillë sot me gëzim u përcjellë Shkodra, lama e nana e heroizmit t'uej. Jo, nuk u lëshon ju Shkodër lokja, ambel pa u puthë në të dyja faqet, thekshem pa u lëmue të dy krahët, përmallshëm pa u derdhë dy pika lotësh, lotë gëzimi e pikllimi, mbi Eshtënt t'uej.

Eshtën të pamort, u falem! Të pavdekshëm, po, pse nder vême t'ueja rueni nji visar të çmueshem, njat ide e cila e patrandun do të jesë ndër né deri sa të jetë Shqipnia.

E udha e mbarë u kjoftë! Veç, o burra, qi vdekun flitni; të mbetun, ngjalleni; të hupun, sot ndritni, kah rreth e rrokull t'i bini Shqipnisë, deh, lëshonje nji za, at zanin t'uej kumbues si të luajve, diftoni djelmnisë Shqiptare shka u a ushqeu idealin, shka u a mbajti karakterin, shka u bani të pavdekshëm. Diftoni, po, se ka e do të ketë Shqipni deri sa të kemi e të mbajmë nji Zot mbi vehte; ka, po, Shqipni deri sa të dalin Shqiptarë fatosa; ka dhe do të ketë Shqipni derisa gjaku i juej i kërthnestë e i gjallë të vlojë në kujtim e ndër ndjesi të Shqiptarvet, deri qi në Shqipni, pa ndryshim krahine e besimi, të çmohen

e të madhnohen thëmeluesat e Atdheut.

Kemi pse të jemi e të mahemi Shqiptarë, der të shêjte të ruhen bes' e burrni. Me të tanë fuqinë t'uej vigane m'i a bani nji urim Shqipnisë; m'i ndiellni të mbarë e përparim, paqë e ngadhnjim. Por edhe nji nâmë si rrëfeja, m' i a lëshoni kulshedres së ré, rrymvet dermuese, qi po e brejnë jetën Shqiptare: atyne po, të cilët thonë se po bashkojnë e na shkatrrojnë: levdohen për dashni, e na qesin mënin e fitmen, duen të na mësojnë e po na zhburrnojnë. Hèu! Ata mos kjofshin, e Zoti i vraftë njata, të cilët duen t'i lanë Shqiptarët pa besë ndër veti, duen t'i qesin nga morali dhe karakteri, nga familjet e historia. Nuk po u pyes kush jeni e kah po vén. Kudo shkojshi, të bardhë kjofshi; ku ndejshi, flori ndritshi. Ideali i juej më tregon se kush jeni, vdekja e juej më dishmon se ku dueni. Nuk më duhet gja kush u vrau, por knaqem, kah marr me mend até për shka ju ratë preja e dorës mizore. Nuk marr parasyshë ç' krahinë kjet e ç' besim patët, më mjafton të dij se besuet në nji Zot, e si kristal i kulluet rrodhi ndër dêjt t'uej gjaku Shqiptar. Ju mësyt Shkodrën për strehë Atdhetarije, për lamë veprimi, për strofull sigurie. Edhe Shkodra me kënaqë ju priti e iu dha nderimin që ju përkittë: pa ndryshim ju rreshtoi nder fatosat e vet, nder të vdekunit e pavdekshëm, krahas me nji Dedë Gjo' Lul e tjerë sokola.

Eh, moj Shkodër, moj mizore! Si s'u ngine ma njiherë me gjak? Deri kur ma do të m'i a këndojsh kangen vdekjes e shemtimit? Shka asht në ty qi dukesh si të ngadhnojshe ma fort mbi vdekje se sa mbi të gjallë, si të gëzojshe ma fort për të mbetun se për të gjallë? Me shka ma mund do të shuhet ajo etja e jote, qi tash sa mot të rreshkë e të pervlon?…

Ti, mizore njimend, por fatose, pse sikurse në djep t'and perkunde burrat e maleve, ashtu në prêhën t'and mblodhe, në votren t'ande rreshtove kreshnikët e Kombit. Mizore, po, por trimneshë, pse kurdoherë në vdekje pave shpetimin; në therori, fitimin; në burrni, forcen. Mizore po, por fisnike, pse nderë e burrni i pate gjithmonë per piri.

Zotnij të ndritshëm! Nuk due t'u ndali mâ. Keni udhë të gjatë. Merrni këto visare të çmueshme, e shkoni! Por para se të niseni, eni këtu, e mbi këta Eshtën, shëmblles ideali, force dhe bashkimi, t'ia shtrijmë dorën shoqishojt, Toskë e Gegë, muhemdanë e kristjan e me besën e burravet, me besën Shqiptare, të lidhemi për t'i a mbajt Shqiptarit të pa prekun nji Zot të vertetë, nji Atdhé të lumtun, per të bamë Shqipninë e ré, të fortë e të madhnueshme, të dêjë per Skenderbéun. T'i diftojmë, po, Botës, se Shqiptarët janë njimênd burra; se mund të jemi Tosk' e Gegë, muhamedanë e kristjan, e njiheri Shqiptarë të njimendët.

Zoti i vertetë e Atdhéu lè të na bashkojnë, Zoti e Atdhéu t' na mbajnë; Me Zot e me Atdhé të lumnojmë! Shënim nga Fritz RADOVANI: Kopjue nga "Hylli i Dritës", fq 462, viti XII, nr.9, Shkodër 1936. Kjo fjalë u mbajt nga At A. Harapi, tek balkoni i Postës në Fushën e Çelës.

***

Me këtë rast, Organizata e Veteranëve dhe Pasardhësve të LANÇ të Bashkisë së Shkodrës, së bashku me përfaqësues të organizatave dhe partive politike, bënë homazhe e vendosën kurora pranë lapidarit që shënon vendin e vrasjen e luftëtarëve.

Gazetari
Musa Kurtulaj

Qëndresa Populllore e Kodrës së Palçit dhe Qafës së Agrit kundër ekspeditës ndëshkimore të Turgut Pashës, korrik 1910

- NË KUADRIN E 116 VJETORIT -

Pas qëndresës heroike të luftëtarëve të Kosovës të udhëhequr nga Idriz Seferi, Isa Boletini dhe Hasan Hysen Budakova në Kaçanik, Caralevë e Budakovë, në prill 1910, kundër forcave të ushtrisë osmane, këto të fundit, me 12 qershor 1910, filluan operacionin në perëndim të Rrafshit të Dukagjinit. Duke pas parasysh qëndresën e fortë që Malësia e Gjakovës i kish bërë një vit më parë ekspeditës së Xhavit Pashës në Qafën e Morinës, në krye të divizionit të dytë, që do të sulmonte Malësinë u vu vetë gjenerali më i shquar turk Shefqet Turgut Pasha, i cili u nis nga Gjakova për t'i ra Malësisë. Plani i komandës xhonturke ishte, që operacioni të kryhej në drejtim të Qafës së Morinës–Qafës së Kolçit–Qafës së Agrit–drejt Shkodrës, ku do të vepronin 18 batalione këmbësorie dhe disa skuadrone kavalerie të përforcuara me bateri artilerie. Ndërkohë, rreth 2000 malësorë nga Gashi e Krasniqja të mobilizuar nën kushtrimin tradicional dhe të prirë nga prijësit e njohur populllor Zeqir Halili, Sadri Bardhi, Halil Brahimi, Abdulla Hoxha e të tjerë. zun pritat në frontin e Qafës së Morinës për të mos lejuar ushtrinë turke të hynte në Malësi. Turgut Pasha, ashtu si paraardhësi i tij Xhavit Pasha, përdori metodat më të egra çnjerëzore për të nënshtruar vendin. Përveç qindra goditjeve me artileri, ai dogji e shkatërroi pothuaj të gjitha shtëpitë e krahinës së Gashit. Në këto luftime të përgjakshme dhe heroike u vranë dhe u plagosën shumë luftëtarë malësor. Forcat operative osmane duke pas epërsi të theksuar ushtarake në numër dhe armatime arritën të hyn në Gash, Krasniqe dhe Bytyç, duke bërë të mundur edhe vendosjen e administratës xhonturke në Malësi. Këto forca pushtuese së bashku me shtabin e tyre drejtues u përqendruan në livadhin e Fangut të Mulosmanaje, i njohur më pas si "Livadhi i Turkut", dhe prej aty ushtria sulmonte pa ndërprerje fshatrat, rrëzonte kullat, grabiste bagëtitë dhe kapte e arrestonte kryengritësit, të cilët pasi i torturonte i dënonte me burgim. Ata filluan menjëherë çarmatimin e kryengritësve, regjistrimin e populllsisë e të pasurisë, mbi bazën e të cilit do të vileshin taksat. Të gjithë burrat nga 16 deri në 60 vjeç u regjistruan për t'i mobilizuar si rekrut në ushtrinë turke. Njerëzit, veçanërisht të rinjtë, kapeshin nëpër shtëpi, dërgoheshin në vendin e tubimit, pastaj transportoheshin drejt Selanikut dhe vendeve tjera të Azisë për të krye shërbimin ushtarak për hesap të Turqisë. Për t'u shpëtuar këtyre rrezaljeve: çarmatimin, rekrutimit për në ushtri, regjistrimit të tokave e bagëtisë dhe pagimit të taksave shumë banorë të Gashit e të Krasniqes qenë detyruar të dalin malit dhe të organizojnë grupe kaçakësh, të cilët herë pas here sulmonin forcat turke. Nga masat që mori qeveria xhonturke me këtë rast kundër shqiptarëve në Kosovë e Malësi. çarmatimi i përgjithshëm ishte masa më e rëndë që bëri përshtypje të thellë në popull. Kjo masë u hiqte shqiptarëve mjetin më të efektshëm, jo vetëm për t'i rezistuar politikës shtypëse e arbitrare xhonturke, por edhe për të mbrojtur vendin nga grabitqarët shovinistë serbomalazezë. Në vijim të planit të tyre për nënshtrimin e plotë të "malësive të pabindura" forcat turke bënë organizimin për të sulmuar Nikaj–Merturin e Dukagjinin. Ndërkohë malësorët e Nikaj–Merturit, që ndiqnin me vëmendje ngjarjet e zhvilluara në Kosovë, Gash e Krasniqe, terrorin dhe mizoritë e pashembullta që forcat turke kishin ushtruar kundër populllsisë që organizoi rezistencën heroike në Caralevë, Kaçanik, Rrafshin e Dukagjinit, Qafën e Morinës, Gash. Krasniqe, Bytyç e kudo gjetkë, e shihnin çdo orë e më të afërt mundësinë e ndeshjes me atë furtunë shkatërruese që kish vendosur të nënshtroi shqiptarët. Për t'i bërë ballë asaj, në fund të qershorit 1910, rreth 200 burra të Nikaj–Merturit u mblodhën në kuvend tek Kodra e Bek Selimit–Lekbibaj.

Iniciatorët e këtij kuvendi Prelë Tuli e Man Avdia e të tjerë. u përpoqën të bindin kuvendin që rezistencën kundër forcave të Turgut Pashës ta bënin së bashku dhe të përqendruar në Qafën e Kolçit. Por kjo nuk u arrit. Shumë pjesëmarrës argumentuan se krahina nuk kishte forca që mundë të përballeshin me një ushtri moderne të asaj kohe siç ishte ajo e Turgut Pashës. Malësorët nuk kishin as minimumin e armëve të armikut. Në kushte të tilla, argumentuan ata, populli do të terrorizohej dhe e tërë krahina do të digjej e plaçkitej, prandaj preferuan qëndresë të organizuar me luftë kaçakësh, me sulme të herëpashershme dhe të befasishme.

Por Man Avdi dhe Prelë Tuli kishin këmbëngul për një ndeshje të drejtpërdrejtë me armikun, prandaj kur po largohej nga kuvendi ky i fundit kishte thënë: "Do të gjendet një qafë tjetër ku turku ka për t'u ndesh me armët tona". Lidhur me këtë këmbëngulje të Prelë Tulit, kronisti i asaj kohe Kamilio Libardi, do të shkruante: "Shkaktari e frymëzuesi i këtij qëndrimi armiqësor kundër qeverisë turke ishte Prelë Tuli i Salcës, një shqiptar i vërtetë nga origjina, nga fama e nga bëmat". Ndërsa revista Hylli i Dritës 1937, kur përshkruan qëndresën e vitit 1910, duke shkruar: "Prelë Tuli, ai Leonidhë i maleve, doli përpara ushtrisë më të madhe të kohës me një grusht malësorësh". Pas kuvendit të Lekbibajt, një kuvend tjetër do të organizohej. Ai i fshatrave Salcë, Palç e Brisë, ku u lidh besa për qëndresë kundër forcave turke. Kuvendi zgjodhi shtabin drejtues të përbërë nga Prelë Tuli, Man Avdia, Sadik Gjergji e Deli Tahiri, të cilët do të udhëhiqnin luftën kundër një ushtrie të madhe të pajisur me armët më moderne të kohës. Kodra e Palçit do të ishte krye prita që do tu bëhej forcave turke, dhe aty që kishte caktuar Prelë Tuli e Deli Tahiri me dhjetëra burra të Salcës, të cilët do të mbronin vendin me çdo çmim. Më në jug do të vendosej Man Avdia e Sadik Gjergji me burrat e Palçit, ndërsa më në veri, në Kokdoç e Sukë të Mark Vatës do të zinin pritat burrat e Brisës. Gjithashtu u morën masa për mbrojtjen e populllsisë, furnizimin e luftëtarëve me ushqime e municion dhe vendosjen e lidhjeve me fiset tjera të Dukagjinit. Për këtë qellim, tre ditë përpara se të niste lufta Prelë Tuli dhe Sadik Gjergji shkuan në Shalë tek kisha e Abatit, ku morën takim me të parin e Djelmnisë së Shalës–Mehmet Shpendi, famulltain atdhetar Padër Çiril Cani dhe burra të tjerë të parisë si: Pepë Ndreun, Çun Nikën, Marash Delinë, Cukel Delinë, Mirash Ndoun e të tjerë. Këta, në emër të krejt Dukagjinit deklaruan se Dukagjini do të organizonte qëndresë të armatosur në kufij e tij. Pra, Kodra e Palçit dhe Qafa e Agrit do të ktheheshin në epiqendra të rezistencës së armatosur kundër forcave osmane. Ato do të bëheshin dy llogore të pakalueshme për ushtrinë pushtuese.

Me 5 korrik 1910, forcat operative të ushtrisë turke me në krye shtabin e tyre drejtues u nisën nga Livadhi i Bujanit drejt Nikaj–Merturin në dy drejtime: Grupi i pare në drejtim të Geghysenit e Qafës së Kolçit, dhe i dyti, në krye të të cilit qëndronte tradhtari Ali Begu, në drejtimin Bujan - Rajë–Tetaj dhe Nikaj. Pas disa orë luftimesh të zhvilluara në Qafën e Kolçit, forcat turke nga të dy drejtimet arritën të depërtojnë në krahinë dhe të vendosin shtabin e tyre në kishën e Nikajt, prej nga filluan operacionin e mbledhjes së armëve në fshatrat e Nikaj–Merturit. Në kuadrin e këtij operacioni komanda turke thirri përfaqësuesit e fshatrave Palç, Salcë e Brisë, të cilëve do tu kërkonin dorëzimin e armëve dhe nënshtrimin ndaj kërkesave të forcave osmane. Ata, jo vetëm nuk u paraqitën, po dhe i dërguan fjalë komandës turke "Hajde merri armët!" Ky ishte një deklarim mospërfillës e kërcënues që tregonte qartë se këto fshatra kishin vendosur të mos i bindeshin urdhrave të komandës turke. Të indinjuar nga mosparaqitja e krerëve të tre fshatrave, forcat turke, me 10 korrik 1910, sulmuan Kodrën e Palçit. Që në përpjekjet e para në afërsi të Kodrës së Palçit, pararoja e armikut u ndesh në rezistencën e fortë të 70 luftëtarëve malësor të prirë nga Prelë Tuli. Lidhur me këtë përpjekje, epika historike-kronikë kryesore e asaj kohe thotë:

"Qaj Prel Tuli trim i çartun,
Qet manxerre e vret bimbashin,
Zjerm i gjallë mbas tij djelmnia,
Trim i rrallë ky Man Avdia ..."

Prej këtu armiku, pasi la disa të vrarë, u detyrua të ndërroj drejtim dhe mori rrugën drejt Qafës së T'therme nga ku mundë të fuste më mirë në shënjestrën e artilerisë së vet fshatrat Salcë, Brisë dhe Qafën e Agrit. Luftëtarët populllor menjëherë zunë pritat në Kodër të Palçit dhe përqendruan forcat kryesore tek Guri Murg, përballë Qafës së T'thermes, duke u prerë të gjitha rrugët dhe mundësitë e kalimit të forcave armike. Guri Murg, ku ishin mbërthyer fort, si shqipja pas shkëmbit, që për luftëtarët e Palçit, Salcës dhe Brisës u bë fortesë e pathyeshme për forcat armike. "Guri Fatal" e quajtën ata, pasi në këmbët e tij lan shumë të vrarë e të plagosur. Armiku për disa ditë rresht ndërmori sulme të fuqishme kundër pozicioneve të luftëtarëve populllorë. Ata goditën me forca të shumta e të përqendruara të këmbësorisë dhe me artileri, por pa sukses. Sepse malësorët e njihnin mirë terrenin dhe ishin zotë të tij. Këta përdorën me mjeshtëri taktikën e kundërsulmit të shpejtë e të befasishëm, ditën dhe natën, në pika të ndryshme e me forca të pakta. Siç deklaronin vetë oficerët osmanë, kishin të bënin me një armik që duket në një pikë, sulmon, pastaj zhduket për të dal menjëherë në një pikë tjetër" Ndërsa një korrespondent ushtarak i asaj kohe. që shërbente në Stamboll shkruante ne revistën "Novaja Vremja" të Petërburgut për luftën e shqiptareve: "Luftojnë tue ndjekur një sistem të ri që, po të flasim troç, s'është më luftë e guerileve. Me një fjalë vihet re se në mënyrën e tyre të të luftuarit ka diçka të re".

Rezistencën heroike të malësorëve–qëndrestarë e mbrojtës të lirisë nuk e thyen breshëritë e vijueshme të mitralozave, as gjylet e topave prej çeliku që u hodhën pa kursim mbi ta dhe kullat e tyre. Sipas dëshmisë së një ushtari turk, pasqyruar në kronikat e Kamilio Libardit, "vetëm gjatë një dite ai kishte hedhur nga pozicioni i tij 37 gjyle". Me piskamën kushtrimtare e vendosmëri shqiptari, malësorët mahnitën pashallarët turqë. Kënga populllore me një figuracion artistik mjaft të goditur thotë:

"Pasha shkruen letra te mbreti:
Kurr s'kam pa ksi soj mileti!
Qes me top gjylen ma kap,
Qes me pushkë m'i hallakatë!
Mitralozit m'i thotë rrokaç ... ".

Po cilët ishin ata prijës e luftëtar trima e guximtarë që ato ditë të nxehta të korrikut 1910, të mbërthyer në shkëmbejt e kësaj toke siç ishte Guri Murg, i kishin dalë ballë për ballë ushtrisë së fuqishme osmane që komandonte Turgut Pasha?! Ata ishin nikaj-merturës. Të gjithë banorët e fshatrave Brisë, Salcë dhe Palç. I madhe i vogël, që nga fëmijët dhe gratë e deri tek pleqtë. Burrat që ishin për pushkë i kishin rrokur ato dhe luftonin në Kodër të Palçit dhe në Gurin Murg, ndërsa të tjerët: dikush sillte municion dhe ushqime luftëtarëve, të

tjerët bluanin dhe gatuanin e disa të tjerë mbronin bagëtitë nga grabitjet. Të pa harruar, me nder e lavdi janë skalitur në historinë e Nikaj–Merturit emrat e grave nga Palçi, Zojë Markja dhe Lulë Sylja, të cilat u kacafytën me ushtarët turq e dhanë jetën duke mbrojtur pragun e shtëpisë së tyre.

Në ato luftime, që vazhduan disa ditë u derdh dhe gjak. Prel Tuli mori plagë të rënda, Vat Luci, Sokol Toma, Çun Doda, Grimc Ndou gjithashtu u plagosen gjatë përleshjeve me armiqtë në vijën e parë të frontit. Ndërsa Vogël Muslia dha jetën duke mbrojtur shtëpitë e fshatit që të mos i djeg osmani. Ndërsa, nga Kodra e Palçit e deri në T'therme të Nikajt e në Gurin Murg kërciste pushka, mitralozi dhe topi, nga Kunora, në Qafë të Agrit, të Nërmajëns, të Valbonës e deri në Qafën e Pejës kishin zënë pritat

Shala, Shoshi, Toplana e gjithe Dukagjini. Me të kris pushka në Kodër të Palçit trimi i radhë Mehmet Shpendi kishte lëshua kushtrimin në Shalë e Dukagjin: "O hiq kushtrim se ne ra turku!". E si vetëtima ishin organizuar e mësy qafat më shumë se 1000 burra të armatosur. Epika historike e ka përcjell brez pas brezi këtë moment heroik me vargjet:

"Ka dal Shoshi shpi për shpi,
Tuj lut festë me mik e bijë,
Pushkën n'dorë qirat në gji,
Deli Marashi u ka pri,
N'qafë Kunorë kan dal shefi ...".

Duke u mbështetur në përvojën e luftërave të mëparshme, Mehmet Shpendi–udhëheqës i Djelmnisë së Shalës, po dhe udhëheqësi kryesor i kësaj qëndrese antiosmane, do t'i ndante forcat e luftës sipas zonave përkatëse: - Luftëtarët e Thethit, me në krye Prel Gjeloshin, Lekë Currin (Gjeçaj), Kolë Markun e Dush Perën (Fushë), Mar Kolën (Ndërlysa) do të ruanin ditë e natë Qafën e Pejës dhe të Valbonës; – Luftëtarët e Pecaje, Abatit dhe Pjollit do të zinin Qafën e Ndërmajëns ku do të ishin: Mehmet Shpendi, Prelë Marku, e Pepë Ndreu i Shalës, Çun Nika, Marash Kokaj). Kështu brenda 6 orëve luftëtarët nga i gjithë Dukagjini, të betuar se, "këtu turku nuk kalon!" kishin zënë çdo shteg e çdo qafë, nga Shtreziqja deri në Qafën e Pejës, duke formuar një front mbi 20 km të gjatë. Lidhur me këtë Padër Çiril Cani – famullitar i Shalës, me 14 korrik 1910, do t'i shkruante kolegut të tij në Shosh P. Kamilio Libardi: "Dje kam kenë në Qafë të Agrit... shaljanët e kan qit cekën me u ba copë e grimë e me qindrue për Atdhe...". Kështu forcat turke të gjeneralit të famshëm Turgut Pasha u gjetën në ditët më të vështira që nga krijimi e deri atëherë. Fronti i T'thermes nuk po çahej! Përball kishte Gurin Murg, atë fortesë të pathyeshme ku ishin mbërtyer luftëtarët e Salcës, Palçit e Brisë, të cilët sulmonin armikun pa pushim ditën e natën. Fronti tjetër në Qafë të Agrit e të Ndërmajëns me të shtëna armësh, potere e zjermnije të ndezura që shkulmonin flakët përpjetë i priste nga çasti në çast. E përveç këtyre, turqit po përballeshin nga dita në ditë edhe me një front tjetër mjaft të vështirë në prapavijat e tyre. Ata vërtetë kishin mundur të hynë në shum fshatra të Nikaj–Merturit, duke filluar nga Raja e deri ne Palç e Peraj. Kishin zaptuar kishën e Rajës, të Nikajt e të Palçit

Prelë Tuli



Mehmet Shpendi - Nderi i Kombit

"Mehmet Shpendi trim si motit!
Vrik piskati nëpër fis,
N'kamë o djelm' heu ndima e Zotit!
Se n'Mertur pushka u nis....".

Ndërsa revista "Hylli i Dritës", 1937, do të përshkruante kështu gatishmërinë, shkathtësinë dhe shpejtësinë me të cilën Dukagjini ju përgjigj thirrjes së Atdheut, duke zënë qafat e duke i kthyer ato në qëndresa të pakalueshme për ushtrinë turke: "Në atë be, në atë lidhje, - theksonte ajo - doli kush kje djalë për pushkë, e nisën me u shpërnda malit me pushkë e sopata, me shyetën e torrokopë, tuj këndue e tuj qit pushkë si të ishin tuj shkue në dasëm. Puna ma e par kje me zanë shtigjet ndër qafa e lugje, me prishë rrugët, me pre e me rrezua landë për me pengue kalimin, Delia e Shytan Nika (me Lekaj), Cukel Delia, Pal Vatush Leka e Mirash Vatë Leka (me Abat), Çun Kola (me Qukë), Prel Gjeloshi (me Pjoll); – Qafën e Agrit do ta zinin Lulash Preka e Mirash Ndou (me Vuksanaj), Bejte Ndoci, Shytan Vuksani (me Lotaj), Binak Kola (me Dakaj), Syk Marku (me Nënmavriq), Çuk Delia dhe Avdi Kola me Gimaj dhe Plan; – Shoshi dhe Toplana me prijësit e tyre: Gjelosh Kola, Deli Marashi (prijës), Babun Celi, Balë Gjoni, Mark Milani, Mëhill Nika, Zmal Preka, Shiqer Ndou, Qerim Ndou dhe Rrustem Lulashi, do të zinin Qafën e Kunorës dhe të Shtreziqes. Këtu do të përqendroheshin edhe luftëtarët e Dushmanit: Lulash Dema (vojvodë) me Papaj; Sokol Bala (me Vasaj) e Mirash Prela (me duke nxjerr përjashta famullitarët e kthye ato në kazerma dhe komanda ushtarake, kërkonin çdo ditë çarmatimin e popullsisë, sulmonin kullat e bagëtitë duke grabitur e plaçkitur çfarë mundënin e ku mundnin, por malësorët e këtyre fshatrave nuk ishin nënshtruar. Ata krijuan grupe kaçakësh, të cilat u vunë në mbrojtje të popullsisë dhe të pasurisë duke sulmuar here pas here forcat turke. Objekt i sulmeve të këtyrë grupeve, në mënyrë të veçantë, ishin karvanet që vinin me ndihma nga Gjakova dhe Krasniqja nëpërmjet rrugës së Qafës së Kolçit, të cilat sillnin ushtarë, municion dhe ushqime për forcat turke. Siç thuhet në "Hylli i Dritës", 1937, "Ndër këto luftime u dan në shëj për trimni bajraktari i Nikajve Sokol Basha, Shytan Brahimi-krye i Nikajt, Gjelosh Rama i Currajt Epërm, Dedë Trimi-krye i Merturit, Tunxh Miftari– bajraktar, Sadik Gjergji shpi e parë në Palç e sidomos trimi i Salcës Prel Tuli, i cili ku me fjalë, ku me urti e burrni diti me trimnue Nikaj e Mertur, tuj pri ai vetë ma i pari në çdo luftim...". I gjendur ne një situat tepër të vështirë pas 14 ditë luftimesh, midis malesh dhe honesh të pa shkelura ndonjëherë nga ushtritë e huaja, ku kriste pushka kundër forcave turke nga Qafa e Kolçit deri në Qafën e Agrit, gjenerali Turgut Pasha e kish kuptuar më në fund se malësia e Nikaj– Merturit dhe ajo e Dukagjinit ishin të pakalueshme për ushtrinë e tij. Ai nuk e mori dot guximin të sulmonte Qafën e Agrit ndaj urdhëroi Ali Begun të kthehej mbrapsht. Në tërheqje e sipër, duke shfryrë gjithë mllefin për humbjen e turpshme që pësoi, ushtria turke dogji dhe shkatërroj plagosen pa mëshirë çfarë zuri përpara. Të tërbuara, si kafshët e egra kur për vdekje, turqit me 22 dhe 23 korrik 1910, ju turrën Salcës dhe Palçit duke i djegur e rrënuar mbi 60 shtëpi. Shkatërruan ekonominë, duke prerë dhe arat me misër të njomë, rrushet dhe pemët. Këtë terror të shfrenuar ata e ushtruan kudo ku kaluan gjatë kthimit për në Gjakovë. Por, gjatë kësaj rruge ata u gjetën edhe nën goditjet e herë pas hareshme të luftëtarëve malësorë, të cilët u shkaktuan humbje të tjera si në njerëz edhe në materiale. Këtë dështim të turpshëm të ushtrisë turke populli e ka përjetësuar në vargjet e këngës së tij:

"Mos pushoni, bini burra!
Anadolli s'po qëndron,
U vu n' tikun nga kufini
Asht ma hana ka kalon,
..Qafës Kolçit rrugës shpumë,
Ku ndjek rruga për në Pejë,
Me ushtri të përgjysmume,
I turpnuem si grue e vejë /...".

Me qëndresën heroike të vitit 1910 kundër ushtrisë turke, krahina e Nikaj–Merturit dhe e Dukagjinit shkruan një nga faqet më të lavdishme të historisë së tyre. Kjo u arrit, sepse këtu në këto male kishte një popull që i printe flamuri kombëtar dhe ideali i lirisë për ruajtjen e vatanit. Qëndresa e Nika–Merturit dhe e Dukagjinit kundër ekspeditës ndëshkimore të Shefqet Turgut Pashës, dhe thyerja e saj këtu në këto male ku ndër shekuj jetonte, punonte e luftonte një popull me mendje të ngulur në liri, ishte flakë e fuqishme në zjarrin e kryengritjes shqiptare të vitit 1910, e cila shënoi fillimin e një etape të re e më të lartë në luftën e popullit tonë për pavarësi kombëtare. Jehona e kësaj qëndrese u përhap kudo në Malësi, Kosovë e mbar Shqipërinë. Ajo fitoj admirim kudo dhe rriti besimin e popullit për fitore të reja. Kjo qëndresë hyri dhe mbeti në historinë e popullit shqiptar si një nga ngjarjet e shënuara të saj. Në 110 - vjetorin e kësaj qëndrese, ne, pasardhësit e atyre burrave dhe grave që luftuan e sakrifikuan gjithçka për lirinë dhe pavarësinë e Atdheut, përulemi plot respekt e mirënjohje përpara sakrificave të tyre, por dhe kemi të drejtën legjitime të krenohemi me baballarët, nënat dhe gjyshstërgjyshërit tanë që na lan trashëgim këto faqe të lavdishme të historisë së kombit.

KOLË ÇARDAKU

Mehmet Shpendi, simboli i qëndresës së Dukagjinit

- NË KUADRIN E 111 VJETORIT TË RËNIES SË TIJ -

Sokol Shpendi i njohur përgjithësisht si Mehmet Shpendi (Pecaj, 1851 - Ndërkiza, 15 korrik, 1915) ka qenë ndër krerët e Shalës në dekadat e fundme të Perandorisë Osmane, bashkë themeloi dhe udhëhoqi Djelmninë e Shalës dhe pjesëmarrës aktiv në Kryengritjen e vitit 1911. U pushkatua nga trupat malazeze gjatë Luftës së Parë Botërore.

Jetëshkrimi

U lind më 1851 në Pecaj të Shalës, në trevën e Dukagjinit të Shkodrës, i vlaznisë së parë të Pecnikës, i njohur me emrin Sokol Shpendi, i biri i Shpend Sadrisë. Prej kësaj vëllazërie kishte qenë edhe njëri prej Shtatë Shaljanëve.

Shpendi u shqua së pari më 1883, kur në Çezme të Koplikut, mbajti qëndrim kundër Komisionit të Xhibalit. Më 1890 u formua "Djelmnia e Shalës", organizim, të cilin Baron Nopça e përshkroi si opozitën e parë shqiptare në gjirin e shoqërinë Malësore.

Pas shpalljes së periudhës së dytë kushtetuese të Perandorisë Osmane më 1908 dhe masave për çarmatosje nga qeveritarët xhonturq, Shpendi mori pjesë në qëndresën që banorët e maleve të veriut i mbajtën fushatës të mbledhjes së armëve, në atë që u quajt beteja e Qafës së Agrit.

…Turgut pasha ish çuditë,
Se ç'do gur i dukej pritë,
Prej çudie ai mori frikë,
K'theu ushtrinë e u nis me ikë...

Këtu po shkëpusim këngën popullore origjinale, që i kushtohet Mehmet Shpendit, dhe kësaj ngjarje të madhe historike;

Bjeshkët e Shalës mblodhën jezerin;
Bjeshkët e Shalës mblodhën jezerin,
Mehmet Shpendi e rrok' manxerrin,
Eni trima te tanë të vdesim,
Hyp mbi shkrep e pisket si zana,
Mbushet bjeshka me djelm azgana,
Veç për luftë i ka lind nana,
Mehmet Shpendi me Djelmni,
I kan n'zan pritat varg e vijë,
Dridhet Pasha në atë Krajli,
Mbi taborre të Tërgut Pashës,
Trimi i Shqipes fort Vikat,
Mbushni hutat me barot t'thatë,
Malet tona mbi shkamb e gur,
Shalë e Shosh, Nikaj-Mërtur,
Trojet tona si l'shojmë kurrë.

Mehmet Shpendi ishte bashkëpunëtorë i ngushtë dhe bashkëluftëtar i pandashëm i Isa Boletinit, me të cilin ai dhe Dedë Gjon Luli jo vetëm luftonin, por nënshkruanin memorandumet e njohura, me kërkesat më të bujshme Historike dhe Kombëtare drejtuar Fuqive të Mëdha Evropiane. Heroi Mehmet Shpendi bashkë me Dedë Gjon Lulin, shkëlqyen me trimëritë e treguar qysh në betejën e Rrzhanicës kundër forcave Malazeze të komanduara nga Mark Milani, duke e thyer atë me turp, në sulmin pushtues që kishte nisur në krye të ushtrisë Malazeze, kundër trojeve tona Kombëtare në atë pjesë të Atdheut.

Memorandum pas Memorandumi;

Përpjekjet e Mehmet Shpendit për çlirimin e vendit, kudo që ai ndodhej, nuk pushuan asnjëherë. Në fillim të vitit 1911, ende pa dalë mirë pranvera, ai do të shkonte në Shkodër për tu bashkuar me patriotët Isa Buletini, Dedë Gjon Luli, Hasan Bushati, Zenel Shabani i Kastratit, Haxhi Muja i Tuzit dhe disa prijës të tjerë të njohur të krahinave Shqiptare, ata do të takoheshin në Cetinë të Malit Zi, të cilët më 23 Mars të ati viti, do të nënshkruanin së bashku një memorandum pesë pikësh drejtuar fuqive të mëdha Evropiane, përmes të cilit do të kërkonin:

1. Të garantohej paprekshmëria e trojeve Shqiptare.
2. Gjuha Shqipe të jetë gjuhë zyrtare dhe të mësohet në shkollat e të katër vilajeteve të tyre.
3. Nëpunësit të jenë vendas dhe të pranohet Kombi Shqiptar.
4. Tatimet vendore të përdoren në vend për rregullimin e jetës së popullit aty.
5. Ushtarët shqiptarë të shërbejnë vetëm në vilajetet e Shqipërisë.[1]

Duke pasur parasysh përpjekjet e tij të pareshtura patriotike, Mehmet Shpendin edhe Akademiku Mark Krasniqi me të drejtë do ta cilësonte si njërin nga Heronjtë e Plejadës së Patriotëve më të mëdhenj të Kombit Shqiptar.[2]

Trimat e Malësisë me në krye Dedë Gjon Lulin u bënë tok' me Dukagjinasit me në krye Mehmet Shpendin. Mehmet Shpendi ishte shokë i ngushtë armësh me Dedë Gjon Lulin, te dy udhëheqës kreshnik të Malësisë së Veriut, nga ku këtu po shkëpusim nji pjesë të nji kënge kushtuar këtyre trimave legjendar;

...Shif i herë at' me flokë të bardhë,
Ai po thojnë asht Dedë Gjo' Luli,
Qi ma i fort nuk bahet burri,
Shifë atë që tash kuvëndi,
Ai pra asht vet' Mehmet Shpendi,
N'daç trim boll, në daç dai,
Mos me ju gjetë shoqi n'Malci...

Me 6 prill 1911, kryengritësit e Malësisë se madhe valëvisin flamurin në Deçiq. Në luftën për ngritjen e Flamurit morën pjese edhe luftëtarë nga Dukagjini, në të cilën u vra Bush Delija i Palajve të Shoshit.

...Vigana tue i dhanë Shqipnis,
Po an'e mban,
Bini, bre burra, bini k'saj Turkie,
Dirgu, moj djelmni, e bjer në tiran,
Me nji Gurakuq, me nji Ded Gjo' Lul,
Me nji Mehmet Shpend e me nji Prel Tul,
Me ne jan Lek't, që u shkrinë për Shqipni! ..

Me 5 deri 10 Qershor të vitit 1911-të, qeveria Turke shpalli amnisti për luftëtarët e lirisë, duke parë rrezikun e përhapjes së kryengritjes së Përgjithshme, Ministri i jashtëm i Turqisë, kërkon dhe merr takim me udhëheqësit popullor të kryengritjes, Dedë Gjon Luli dhe Mehmet Shpendi, të



cilët ata i thonë; "Sado që ti je ministër i Sulltanit, ne e kemi për turp me bisedua me ju. Vetëm arma e baruti, do të jenë përgjigja e jonë …".

Më 23 Qershor të vitit 1911 si përfaqësues i "Djelmnis së Shalës", Mehmet Shpendi do ta nënshkruante edhe Memorandumin e Greçës. Emrit të Mehmet Shpendit i shtohet shkëlqimi edhe më tepër në luftimet e Kryengritjes së përgjithshme Kombëtare të vitit 1912, duke i bërë jehonë historisë së çlirimit sidomos në Gushtin e atij viti, kur në krye të luftëtarëve Dukagjinas, pas luftimeve historike përkrah Bajram Currit e Zeqir Halilit do të hynin bashkë dhe ballëhapur, si heronj Kombëtar në Shkupin e çliruar.

Takimi te Ura e Shalës dhe ngritja e Flamurit në Abat;

Në aktivitetet e pareshtura Kombëtare të Mehmet Shpendit, n'drit edhe në takimin me të gjitha fiset e Dukagjinit, organizuar me 28 Maj të vitit 1911, në vendin e quajtur, te Ura e Shalës, ku nga pjesëmarrësit e kuvendit, do të vendosej, që i gjithë Dukagjini si dhe mbarë Malësia e Madhe, të ngrihej në kryengritje të armatosur kundër pushtuesit Turk dhe Malazez.

Veprimtaria kryengritës i Mehmet Shpendit ishte i pranishëm në çdo cep të Atdheut, kudo që luftohej dhe përgjatë të gjitha përpjekjeve kombëtare, deri në Shpalljen e Pavarësisë së trojeve Shqiptare më 1912. Madje i entuziazmuar për Rilindjen e Kombit Shqiptar, kur nga të gjitha ato luftëra dhe beteja të ashpra Shqipëria do të shpallet Shtet më veti. Ai me të marrë vesh lajmin e gëzuam për Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë dhe ngritjen e Flamurit Kombëtar nga Ismail Qemali në Vlorë, me datë 28 Nëntor 1912-të, së bashku me shumë trima Shaljan dhe Dukagjinas, me krenari do të ngrinte Flamurin Kombëtar edhe në trevën e tij, duke zgjedhur si vendin më të përshtatshëm për këtë ngjarje të madhe historike, vet logun e Kuvendit të burrave të Shalës, në Abat, ata i banë malet të ushtojnë prej kushtrimit dhe gëzimit; "Duel Shqipnia më Veti, i shpëtuem dore Turkut të Stambollës."[3]

Vrasja me tradhti

Fatkeqësisht me gjithë kontributin e tij dhe përpjekjet e pareshtura kombëtare që ndër vite u zhvilluan, gëzimi për Pavarësinë e Shqipërisë dhe çlirimin e Shqiptareve, si për të gjithë popullin tonë ashtu edhe për heroin Mehmet Shpendi nuk do ishte i plotë as jetë gjatë.

Siç është e njohur nga historia, pas përzënies së forcave Turke me luftën e Shqiptareve nga trojet tona, shtetet hegjemoniste fqinje sipas orekseve të tyre të sëmura, pa vonuar do të mësynin dhe copëtonin Shqipërinë nga të gjitha anët. Kurse në vitin 1915, ushtria pushtuese Malazeze, përveç tjerash do të niste sulmin edhe për pushtimin e Dukagjinit të Mehmet Shpendit. Ndaj, ata duke ditë trimëritë e Shaljanve dhe aftësitë luftarake të prijësit heroik të asaj treve si Mehmet Shpendi, gjenerali Malazez Radomir Veshoviq, do ta ftonte udhëheqësin e Shalës në një bisedë "dypalëshe", kinse (sikur) për lidhjen e një marrëveshje armëpushimi me Shqiptarët, siç do ti thoshin atij.

Dhe pasi i kishte shëtitur rreth e rrotull gjatë gjithë ditës, gjoja se udhëtonin për

At Shtjefën Gjeçovi, martiri dhe shërbestari i amshueshëm i vlerave shpirtërore, ngjizësi i "Kanunit të Lekë Dukagjinit"

Nga Albert Vataj

Më 12 korrik 1874, në Janjevë të Kosovës (vetëm 11 km larg Prishtinës), leu At Shtjefën Gjeçovi, një ndër gurthemelet më të njëmendta të vetëdijes sonë kombëtare. Ai dha një kontribut të vyer jo vetëm si klerik i devotshëm, por edhe si veprimtar i pasionuar i vlerave shpirtërore të shqiptarëve, duke u bërë dëshmitar dhe afirmues i asaj pasurie që mbart në vetvete tharmin e ekzistencës së këtij populli.

Ndonëse shpesh e lidhim kryesisht me monumentalizimin e "Kanunit të Lekë Dukagjinit", i cili doli në dritë si vepër e plotë në vitin 1933, katër vite pas pushkatimit të tij nga pushtuesi serb, më 14 tetor 1929 në Zym të Hasit, lëmi i shërbestarisë së Gjeçovit shtrihet shumë më gjerë, duke u kthyer në një vlerë të pamohueshme të kulturës sonë.

Shtjefën Gjeçovi mësimet e para i mori në vendlindje, për t'i vazhduar më pas në Kuvendin Françeskan të Troshanit në Shqipëri, e më tej në Derventë (afër Banja Lukës), Fojnicë e Kreshevë të Bosnjë-Hercegovinës, ku u brumos me disiplinën shkencore dhe fetare. U shugurua prift më 25 korrik 1896 në Zllakuqan të Klinës. Misioni i tij shpirtëror dhe kombëtar e shpërndau pothuajse në të gjitha gjeografitë shqiptare dhe më gjerë:

Në Kosovë: Shërbeu në Zllakuqan, Pejë, Gllogjan, Gjakovë dhe së fundmi në Zym të Hasit.

Në Shqipëri: La gjurmë të thella në Theth, Gomsiqe, Rubik të Kurbinit, Vlorë dhe Prekal të Dukagjinit.

Jashtë trojeve: Shërbeu gjithashtu në Zarë të Kroacisë dhe në Livno të Bosnjë-Hercegovinës.

Pikërisht për këtë veprimtari të ngjeshur zgjimi kombëtar dhe mbrojtjeje të identitetit, ai u ekzekutua pabesisht nga autoritetet serbe në Zym, më 14 tetor 1929. Në veprimtarinë e tij si shkencëtar, Gjeçovi u nis nga parimi thellësisht iluminist dhe patriotik: "Një popull që nuk ka histori të vetën, konsiderohet si një popull i vdekun". Ai besonte me ngulm se visari ynë i vërtetë kombëtar gjendej i mbuluar nëndhe ose në kujtesën e popullit.

Studiuesi dhe arkeologu Selim Islami vëren me të drejtë: "Figura e Shtjefën



Gjeçovit është e madhe dhe veprimtaria e tij e shumanshme, saqë ne arkeologët mund të krenohemi me të si me të parin arkeolog shqiptar. Me emrin e tij lidhen kërkimet e para arkeologjike të bëra nga një shqiptar deri më atë kohë."

Gjeçovi zhvilloi një punë titanike, duke mbledhur objekte arkeologjike dhe materiale etnografike. Ai kundërshtoi me forcë koncensionet arkeologjike, që qeveritë e kohës u jepnin të huajve dhe ngriti i vetëm një muze privat (koleksionin e tij të famshëm), duke mbushur një zbrazëti të madhe kulturore. Në koleksionin e tij ruheshin dëshmi të rralla: Dy çekanë guri (mbase dëshmia e parë e neolitit shqiptar). Sopata bronzi të tipit "shkodran" dhe "dalmato-shqiptar". Një përkrenare ilire, maja heshtash, enë balte dhe monedha antike të Shkodrës, Gentit, Dyrrahut e Apolonisë.

Në fushën e etnografisë, ai u kthye në një "arkiv të gjallë". Mblodhi gjithçka që lidhej me ciklin e jetës së malësorit, që nga djepi deri në varr, duke dokumentuar institucionet morale si besa, nderi dhe burrëria. Akti i krijimit të këtij humanisti përfshin mbi 10 mijë faqe materiale, studime, krijime dhe përkthime.

Veprat e tij ndahen në disa fusha kryesore:

Studime Historike, Arkeologjike dhe Etnografike:

*Nji argëtim arkeologjik (1902)

*Trashëgime pellazge në traditën shqiptare (1914)

*Sebaste s'Armeni apo në Arbëri (1921)

*Trashëgime trako-iliriane (1924)

*Trashëgime ilire në traditën shqiptare (botuar postume)

Vepra Letrare, Dorëshkrime dhe Përkthime:

*Dashunia e Atdheut (1901), Jeta e Shën Luçisë (1904), Agimi i Qytetnisë (1910).

*Përkthime: Atil Reguli (1912), Vajza e Orleansit (1916), Mark Kuli Kryeqitas.

*Në dorëshkrim: Përrallat popullore (1903), Doke e zakone vdekjeje (1907), Mënyra e jetesës në Malci (1908), Doke e zakone dasmash (1910–1911), Vaje (1917–1920).

Mbledhjen e këtij korpusi juridik tradicional e filloi në vitin 1898 dhe e vazhdoi gjer në frymën e fundit. Botimi i vitit 1933 në Shkodër u shoqërua nga një biografi e shkurtër nga At Pashk Bardhi dhe një parathënie monumentale nga At Gjergj Fishta, i cili e mbyllte me fjalët:

"Kaq shkrova jo aq për me shtri nji parathanie kësaj vepre, sa për me diftue mallin e pakufishëm qi kam për të paharrueshmin autorin e saj". Për këtë punë kolosale, Gjeçovit iu akordua titulli Doktor i Shkencave "Honoris Causa" nga Universiteti i Lajpcigut në Gjermani.

Filozofia Politike dhe Vlerësimi nga Bashkëkohësit:

Në veprën e tij "Agimi i Qytetnisë", Gjeçovi shpalos mendimet e tij përparimtare. Në trajtimin e raporteve mes Besimit dhe Atdheut, ai përdor figurën e një peshoreje, ku feja dhe atdhedashuria duhet të jenë në ekuilibër të plotë. Madje, ai shkonte aq larg sa deklaronte se një "shenjt" i kishës nuk mund të quhej i tillë nëse nuk kishte qenë fillimisht atdhetar.

Për këtë shpirt të madh, Gjeçovi gëzonte respektin e elitës intelektuale të kohës. Mbante letërkëmbime dhe takime të shpeshta me Fan Nolin, Luigj Gurakuqin, Nikollë Kaçorrin dhe albanologun e madh Norbert Jokl, ndërsa delegatët e Kongresit të Lushnjes (1920) i dërguan një letër zyrtare falënderimi për kontributin e tij kombëtar.

Kujtimi i Faik Konicës

Në vitin 1930, eruditi Faik Konica botoi në gazetën "Dielli" të Bostonit shkrimin "Kujtime për Sh. Gjeçovin", ku përshkruan vizitën e tij të vitit 1913 në famullinë e izoluar të Gomsiqes: "Një gjë për të vënë re dhe që më mbushi me habi dhe trishtim është se nga Shkodra gjer në Gomsiqe, një udhëtim shtatë a tetë orësh met kalë, s'pamë gjëkundi ndonjë shenjë gjallësie... Po mërzia e udhëtimit na u shpërblye përtej shpresës posa arritëm në Gomsiqe... Famullia, një biná prej guri e ndritur dhe e pastër, gjysmë e zbrazur nga plaçkat, po e mbushur dhe e zbukuruar nga zemra e madhe dhe nga buzëqeshja e të zotit të shtëpisë, qëndronte mikpritëse dhe e qetë anës së një lumi. Këtu rronte at Shtjefën Gjeçovi. Këtu e çonte jetën mes lutjes e mësimeve, një nga njerëzit më të lartë që ka pasur Shqipëria".

At Shtjefën Gjeçovi mbetet pikërisht ky: shërbestar i devotshëm, shkencëtar vetëmohues dhe martir i palëkundur, i cili shkroi me gjak testamentin e amshimit të identitetit shqiptar!

---

bisedime te Krajl Nikolla, Veshoviqi shfrytëzoi mos prezencën e Mehmet Shpendit, për futjen e 1 500 ushtarëve Malazez në trojet shqiptare nga Ura e Mesit ku ishin përqendruar që më parë, duke kaluar fshehurazi qafën e Boshit dhe vendosur në Dakaj të Nënmavriqit të Shalës.

Por me gjithë mungesën e Mehmet Shpendit, Shaljanët trima të vendosur për të dhënë jetën e tyre për vatan, do ti prisnin në mënyrë të merituar "miqtë" e paftuar atje, me ç 'rast pas një beteje të shkurtër, ushtarët Malazez do të mundeshin dhe dorëzoheshin pa kushte që të gjithë. Më 5 korrik të vitit 1915, sipas traditave luftarake të kohës, pas çarmatosjes të palës së mundur në fushëbetejë, ushtarët e kapur Malazez si rob lufte, do të kalonin nën pushkët e kryqëzuara të luftëtarëve Dukagjinas tek Ura e Shalës, të cilët Shaljanët pastaj do ti përcillnin deri në qafë të Pejës, për tu lënë të lirë të ktheheshin në Mal të Zi.

Por me të marrë vesh këtë lajm gjenerali Veshoviq, do të lidhte në pabesi Mehmet Shpendin dhe do të dërgonte një brigadë tjetër ushtarësh Malazez në vendin e quajtur Plan. Madje, aty do të vinte edhe vet Veshoviqi, ku në mënyrën më të ulët dhe cinike do të sillte të lidhur për laku të gjithë delegacionin e marrë peng Shaljan me në krye Mehmet Shpendin. Ditën e 15 Korrikut të vitit 1915 në afërsi të vendit të quajtur N'dërkisa, afër Qereshit të Planit, shovinistët Malazez, të udhëhequr nga armiku i përbetuar i Shqiptareve Radomir Veshoviq, përkundër "besës" që i kishte dhënë Mehmet Shpendit dhe delegacionit Shqiptar, ai do të urdhëronte masakrimin e Mehmet Shpendit, Marash Delisë, Çun Nikës dhe të gjithë ata që i shoqëronin. Gjithashtu në fushë të betejës, dhe konkretisht në vendin e quajtur rrasat e qafës së Boshit Gimaj, vritet edhe luftëtari trim Vat Gjeloshi nga Abati, dhe pas kësaj agresorët barbarë vijuan veprimet e tyre mizore luftarake, duke vra e pre mbi 75 burra, gra dhe pleq, të Planit dhe të Dukagjinit, duke mos bërë asnjë përjashtim.

Strategu popullor dhe Udhëheqësi i shquar i "Djelmnis së Shalës" Mehmet Shpendi, përpara se ti mbyllte sytë, ka lanë një amanet, dërgua fisit të Shalës dhe tanë Dukagjinit;

"Tokë e qiell dorzan ju paça lanë, besë anmikut kurr mosë me i n'zanë".

Amanet, të cilin me dëshirë do ta kishte lanë edhe Çerçiz Topulli, vrarë po ashtu me urdhër të Gjeneral Veshoviqt, i cili pas masakrimit të mbi 2 000 Shqiptarve të Kosovës dhe rrethit të Shkodrës, më 15 korrik të vitit 1915, kishte zgjedhë fushën e famshme të Shtoijt ku dikur Shaljant legjendar kishin lidhë besën me "Shoqi-Shoijn".

Numri i të vrarëve të figurave më madhore të popullit tonë në prita dhe tradhti, do ti shtoheshin edhe tre heronj Kombëtar, nga tri kënde të veçanta dhe anë të ndryshme të trojeve tona etnike si; Çerçiz Topulli nga Jugu, Mehmet Shpendi nga Dukagjini në Veri dhe Isa Boletini nga Veri-lindja e Atdheut, humbjen e të cilëve jo vetëm se do ta përjetonin rënd, por do e ndjenin gjatë të gjithë Shqiptarët pa përjashtim.

Burime informacioni

1. Lahuta e Malsisë "Mehmet Shpendi", faqe 460-versioni Anglisht. 2005 I.B. Taurus & Co.Ltd, New York").

2. Risto Siliqi "Pasqyra e ditëve të përgjakshme" Trieste, 31 Korrik, 1912.

3. Pal Doçi, "Mehmet Shpendi i pari i djelmënisë së Shalës" ,Tiranë, 1966.

4. Akademik Mark Krasniqi "Gjurmë e Gjurmime" 1979, Prishtinë.

5. Shqipëria.com, Kryengritja e Kosovës e vitit 1910.

6. Shqipëria.com, Kryengritja e Përgjithshme e vitit 1912.

7. Libri "Krijuesit e Historisë" Prishtinë, viti 2012.

9. Prël Milani dhe Lazër Kodra "Studime".

NDUE SANAJ

“Djep në udhëkryq” - ku “jeton” simbolika e jetës mes kujtesës, ikjes dhe shpresës

Vëllimi poetik “Djep në udhëkryq” i poetit Myrto Hysaj (ShB “Fiorentia”, Shkodër, 2026) që në titull, na sugjeron një poezi të lidhur me kujtesën, familjen, kohën dhe dilemat e njeriut bashkëkohor. “Djep në udhëkryq” - simbolika e jetës mes kujtesës, ikjes dhe shpresës...

Titulli i një vepre poetike shpesh është çelësi i parë i interpretimit. Në rastin e vëllimit “Djep në udhëkryq”, dy fjalët kryesore - “djep” dhe “udhëkryq” - krijojnë një përplasje kuptimore të fuqishme. Djepi është simboli i fillimit, i lindjes, i fëmijërisë, i familjes dhe i vazhdimësisë së jetës. Ai lidhet me ngrohtësinë e nënës, me ninullat, me traditën dhe me rrënjët shpirtërore të njeriut. Në kulturën shqiptare djepi nuk është vetëm një objekt shtëpiak; ai është një simbol i trashëgimisë, i gjuhës dhe i kujtesës familjare. Ndërsa udhëkryqi shpreh një gjendje pasigurie, një pikë ku njeriu duhet të zgjedhë një drejtim. Ai bart kuptime të kohës sonë: largimin, emigrimin, ndryshimet shoqërore, përballjen mes së shkuarës dhe së ardhmes. Kështu, “Djep në udhëkryq” mund të lexohet si simbol i një bote ku rrënjët tradicionale përballen me lëvizjet e mëdha të jetës moderne. Djepi që dikur qëndronte në qendrën e shtëpisë, sot gjendet përballë udhëkryqeve të historisë dhe fatit njerëzor.

Tematika e vëllimit poetik

Në qendër të poezisë së këtij vëllimi duket se qëndrojnë disa tema të rëndësishme:

1. *Tema e familjes dhe e lidhjeve të gjakut.* Familja paraqitet si vendi i parë i dashurisë dhe i kujtesës. Marrëdhëniet prindër-fëmijë, sidomos dhimbja e largimit të brezave të rinj, janë një burim i fortë emocional.

2. *Tema e mallit dhe e emigrimit.* Në shumë poezi të kohës sonë, largimi i të rinjve është një plagë shoqërore. Fëmijët që ikin në vende të largëta mbeten gjithmonë të pranishëm në zemrën e prindit. Ata largohen fizikisht, por vazhdojnë të jetojnë në kujtesën familjare.

3. *Tema e kohës dhe ndryshimit.* Poeti vështron kalimin e viteve dhe ndryshimin e marrëdhënieve njerëzore. E kaluara, kujtimet e fëmijërisë dhe realiteti i sotëm bashkohen në një përjetim poetik.

4. *Tema e atdheut dhe rrënjëve.* Edhe kur njeriu largohet, ai mbetet i lidhur me vendin e lindjes. Atdheu shfaqet si hapësirë shpirtërore, si një “qiell prindëror”, siç shprehet poeti në vargjet e dhëna.

Motivet që e shqetësojnë poetin Hysaj

Nga poezia “Jeni hënë e diell” dallohen disa motive themelore:

Motivi i ndarjes dhe largimit - largimi i fëmijëve ose i brezit të ri krijon një dhimbje të heshtur.

Motivi i pritjes - prindi mbetet në vendlindje duke ruajtur lidhjen shpirtërore.

Motivi i mbrojtjes prindërore - edhe largësia nuk e dobëson dashurinë.

Motivi i natyrës si bashkudhëtare e njeriut - dielli, hëna, retë dhe stinët marrin funksion emocional.

Motivi i kujtesës - e shkuara vazhdon të jetojë përmes kujtimeve.

Realiteti i ditës duket i pranishëm sidomos përmes dramës së largimit. Poezia nuk merret vetëm me një ndarje personale, por prek një dukuri të gjerë shoqërore: familjet shqiptare të ndara nga emigracioni. Drama nuk paraqitet me zhurmë, por përmes një dhimbjeje të përmbajtur dhe të fisnikëruar nga dashuria.

Figuracioni letrar

Në vargjet e Myrto Hysajt vërehet një përdorim i pasur i figurave poetike:

Metafora

“Jeni hënë e diell” është metafora qendrore e poezisë. Fëmijët krahasohen me dy burime drite, me dy forca që i japin kuptim jetës së prindit.

Personifikimi

Natyra merr tipare njerëzore: “retë puplore” bëhen si një mbulesë mbrojtëse; dielli shndërrohet në një dorë që përkëdhel; hëna lidhet me ëndrrën dhe kujtesën.

Simboli

Dielli - dashuria, ngrohtësia, jeta.

Hëna - kujtesa, ëndrra, prania në mungesë.

Zogjtë shtegtarë - njerëzit që largohen, por ruajnë lidhjen me folenë.

Qielli prindëror - vendlindja, familja.

Epitetet poetike

Shprehje si: “retë puplore të vjeshtës”, “dimër me akull dhe acar”, “qielli prindëror” krijojnë një atmosferë të ndjeshme dhe pamje të gjalla.

Analizë e poezisë “Jeni hënë e diell”

Kjo poezi është një këngë lirike e dashurisë prindërore. Subjekti lirik i drejtohet të larguarve me një zë të mbushur me mall dhe bekim. Ai nuk ankohet për largimin, por e shndërron dhimbjen në dashuri.

Vargjet:

“Dhe në shkofshi në fund t’ planetit
Do t’ju puth me buzët e Diellit.”

shprehin fuqinë e një dashurie që nuk njeh largësi. Edhe hapësira më e madhe nuk mund ta ndërpresë lidhjen shpirtërore.

Në vargjet:

“Me syt’ e Hënës n’ andërr kam me u gjetë!” shfaqet një figurë shumë e bukur poetike: prindi e gjen fëmijën jo vetëm në realitet, por edhe në botën e ëndrrës. Hëna bëhet syri i kujtesës.

Strofa:

“Rini e larguar mbetet zogj shtegtarë në qiellin prindëror jeni Hënë e Diell.” është kulmi kuptimor i poezisë. Të rinjtë janë zogj që udhëtojnë, por qielli i tyre i parë mbetet familja. Ata janë larg në hapësirë, urë mes traditës dhe realitetit të sotëm, mes vendlindjes dhe botës së largët, mes dhimbjes dhe shpresës. Nëpërmjet figuracionit të natyrës dhe gjuhës së ndjenjës, poeti e shndërron përvojën personale në një përjetim të gjerë njerëzor.

Libri poetik “Djep në udhëkryq” ka në përmbajtjen e tij poezi ku ndërthuren kujtesa, familja, tradita, dashuria prindërore dhe shqetësimet e kohës sonë. Vëllimi si “Djep në udhëkryq” i poetit Myrto Hysaj është interesant, pikërisht, sepse krijon një lidhje mes botës së brendshme të poetit dhe dramave njerëzore që përjeton shoqëria.

Xhahid Bushati
Shkodër, më 15.07.2026

Janë shqiptarët për ty, Shqipëri!

Shqipëri, o Nënë e shenjtë,
n'historinë tënde të rrallë.
Do të jem unë bir i denjë,
do të jem një gur i gjallë.

Ti je Nënë gjithmonë me nder,
ti je toka e larë me gjak.
E pamposhtur je përherë,
je shqiponja mbi bajrak!

Ndaj gjithmonë plot dashuri
do të këndoj në tokën mbar':
Nëna ime, je ti, Shqipëri,
emri yt më bën krenar.

S'do të pres nga askush tjetër,
të vërë dorë mbi këtë ndërtesë.
Tokë hyjnore, kaq e vjetër,
po ta jap sot ty këtë besë.

Sa t'jen' dielli edhe hëna,
sa të jetojë kjo njerëzi,
sa t'ketë bij lindur nga nëna,
janë shqiptarët për ty Shqipëri!

Do t'këndoj me krenari,
që të dëgjojë bota mbarë:
Janë shqiptarët për ty, Shqipëri,
dhe Shqipëria për shqiptarë!

Poezi nga
Nikolin Sh. Lëmezhi

Beltojë (Shkodër),
më 29. 06. 2026

Dy vendet, që çdo njeri duhet t'i vizitoje shpesh

Nga Suela Ndoja, *Psikologe Klinike | Studiuese në Psikologji Klinike dhe Neuroshkencë*

Jetojmë në një epokë ku shpejtësia është bërë sinonim i suksesit. Çdo ditë zgjohemi mes njoftimeve, afateve, përgjegjësive dhe pritshmërive gjithnjë e më të larta. Jemi mësuar të jemi vazhdimisht në lëvizje, të lidhur me botën dhe gjithmonë të gatshëm për sfidën e radhës. Teknologjia ka zvogëluar distancat, por paradoksalisht shumë njerëz ndihen më larg se kurrë nga vetvetja.Ky është një nga paradokset më të mëdha të kohës sonë: kemi më shumë informacion, por jo gjithmonë më shumë urtësi; kemi më shumë mënyra komunikimi, por jo gjithmonë më shumë lidhje të thella; kemi më shumë mundësi, por shpesh më pak qetësi të brendshme.

Në përpjekjen për të ndërtuar botën tonë të jashtme, shpesh harrojmë të kujdesemi për botën tonë të brendshme. Pikërisht në këtë realitet marrin një kuptim të veçantë fjalët e Tiny Buddha: "*Ka dy vende ku duhet të shkosh shpesh: vendi që të shëron dhe vendi që të frymëzon!*" Kjo nuk është vetëm një metaforë poetike. Është një e vërtetë që lidhet thellë me mënyrën se si funksionon mendja dhe trupi ynë. Është një e vërtetë e mbështetur nga psikologjia, neuroshkenca dhe vetë përvoja njerëzore .Çdo njeri ka nevojë për një hapësirë ku mund të rikthejë ekuilibrin, por gjithashtu ka nevojë për një hapësirë tjetër ku mund të rizgjojë shpresën, krijimtarinë dhe kuptimin e jetës. Por për ta kuptuar pse këto vende janë kaq të rëndësishme, duhet të shohim më nga afër mënyrën se si truri ynë përjeton botën.

Vendi që na shëron

Çdo njeri mbart një botë të padukshme për të tjerët. Brenda nesh ekzistojnë përvoja, kujtime dhe emocione që nuk shfaqen gjithmonë në sipërfaqe, por që ndikojnë mënyrën si e përjetojmë jetën. Disa plagë krijohen nga ngjarje të dhimbshme, humbje apo marrëdhënie që kanë lënë gjurmë. Të tjera ndërtohen gradualisht nga stresi kronik, nga përpjekja për të qenë gjithmonë të fortë, nga përgjegjësitë e shumta dhe nga largimi i vazhdueshëm prej nevojave tona emocionale. Jo të gjitha plagët janë të dukshme, por kjo nuk do të thotë se ato nuk ekzistojnë. Kur mbeten pa u dëgjuar dhe pa u përpunuar, ato ndikojnë mënyrën si mendojmë, si reagojmë dhe si lidhemi me veten dhe të tjerët.

Si psikologe klinike, kam kuptuar se njerëzit nuk kërkojnë ndihmë vetëm pas ngjarjeve të mëdha traumatike. Shpesh ata vijnë të lodhur nga pesha e një jete ku kanë mbajtur shumë përgjegjësi, ku janë përpjekur të jenë të fortë për të gjithë dhe ku kanë harruar të pyesin veten: "*Si jam unë*?" Pikërisht këtu neuroshkenca na ndihmon të kuptojmë një proces të rëndësishëm. Kur një person jeton për periudha të gjata nën stres, truri sillet sikur duhet të përballet vazhdimisht me një kërcënim. Amigdala, pjesa e trurit që lidhet me zbulimin e rrezikut, mund të mbetet tepër aktive, duke e mbajtur sistemin nervor në një gjendje gatishmërie të vazhdueshme. Në të njëjtën kohë, stresi kronik ndikon në funksionimin e korteksit prefrontal, zonës së trurit që lidhet me arsyetimin, vetëkontrollin, planifikimin dhe rregullimin emocional. Kjo shpjegon pse, kur jemi të mbingarkuar për një kohë të gjatë, mund të ndihemi më të lodhur, më impulsivë, më pak të përqendruar dhe më pak të aftë për të parë zgjidhje.

Prandaj, nevoja për një vend që na shëron nuk është luks dhe as dobësi. Është një nevojë biologjike, psikologjike dhe njerëzore. Ky vend nuk është domosdoshmërisht një pikë në hartë. Mund të jetë një shteg mali ku mendja qetësohet, bregu i detit ku ritmi i brendshëm ngadalësohet, një vend shpirtëror ku gjejmë paqe, një bibliotekë ku rikthehemi tek vetja, një shtëpi ku ndihemi të pranuar ose prania e një njeriu që di të dëgjojë pa gjykuar. Ajo që i bashkon të gjitha këto vende është ndjenja e sigurisë. Kur ndihemi të sigurt, sistemi ynë nervor fillon të qetësohet dhe truri rikthen aftësinë për të menduar, për të krijuar dhe për të shpresuar. Shërimi nuk do të thotë të fshijmë të kaluarën. Do të thotë të mos lejojmë që ajo të vazhdojë të drejtojë të ardhmen. Megjithatë, shërimi nuk është fundi i rrugës. Njeriu nuk kërkon vetëm të jetë më pak i lënduar. Ai kërkon të ndihet i gjallë. Dhe pikërisht këtu na çon vendi i dytë.

Vendi që na frymëzon

Një zemër që ka gjetur qetësi kërkon edhe një arsye për të ecur përpara. Frymëzimi është ajo forcë e brendshme që na kujton se jeta nuk përbëhet vetëm nga ajo që kemi kaluar, por edhe nga ajo që mund të bëhemi. Ai na lidh me mundësinë, me krijimtarinë dhe me kuptimin.Një vend frymëzues mund të jetë një libër që ndryshon mënyrën si shohim botën, një mësues që beson tek ne, një artist që zgjon ndjeshmërinë, një shkencëtar që zgjeron kufijtë e dijes ose një njeri i zakonshëm që, pavarësisht vështirësive, zgjedh të ruajë mirësinë.Shpesh njerëzit që na frymëzojnë nuk janë ata që kanë pasur një rrugë pa pengesa. Përkundrazi, janë ata që kanë kaluar vështirësi, por nuk kanë lejuar që dhimbja t'u marrë shpresën. Ata na kujtojnë se forca nuk është mungesa e vuajtjeve. Forca është aftësia për të vazhduar të duash, të krijosh dhe të besosh, edhe pasi ke njohur sfidat. Në këtë kuptim, frymëzimi nuk është vetëm një emocion i bukur. Ai është një burim i rëndësishëm i mirëqenies psikologjike.

Në epokën digjitale, edhe hapësirat virtuale janë vende

Sot një pjesë e madhe e jetës sonë zhvillohet në botën virtuale. Rrjetet sociale nuk janë vetëm platforma teknologjike; ato janë mjedise psikologjike që ndikojnë mënyrën si ndihemi dhe si e perceptojmë veten. Çdo ditë mendja jonë ushqehet me qindra mesazhe, fotografi, komente dhe lajme. Prandaj duhet të pyesim veten: **Çfarë po ushqen mendjen time?** Nëse e mbushim atë me frikë, zemërim, krahasime dhe negativitet, ankthi bëhet pothuajse i pashmangshëm. Nëse zgjedhim përmbajtje që edukon, frymëzon dhe ndërton shpresë, edhe mënyra jonë e të menduarit fillon të ndryshojë. Ashtu si ushqimi ndërton trupin, edhe informacioni ndërton mendjen. Prandaj lind një pyetje e rëndësishme:

Çfarë po ushqen mendjen time çdo ditë?

Ashtu si ushqimi ndikon trupin, edhe informacioni ndikon trurin. Nëse ekspozohemi vazhdimisht ndaj frikës, krahasimit dhe negativitetit, kjo mund të ndikojë gjendjen tonë emocionale. Nëse zgjedhim përmbajtje që edukon, frymëzon dhe krijon kuptim, ne ndërtojmë një mjedis më të shëndetshëm edhe brenda vetes. Nëse vendet ku qëndrojmë formësojnë mënyrën si bëhemi, atëherë lind një pyetje edhe më e thellë: çfarë lloj vendi po bëhemi ne për të tjerët?

Të bëhemi vetë një vend shërimi

Ndoshta ky është mesazhi më i rëndësishëm: nuk mjafton vetëm të kërkojmë vende që na shërojnë dhe na frymëzojnë. Me kalimin e kohës, sfida jonë më e madhe është të bëhemi vetë një vend i tillë për njerëzit që takojmë.Bota ka nevojë për njerëz që dëgjojnë pa paragjykuar. Për marrëdhënie që krijojnë siguri. Për profesionistë që shohin njeriun përtej diagnozës. Për miq që sjellin dritë edhe në ditët e vështira.

Si psikologe klinike, besoj se një nga treguesit më të lartë të pjekurisë emocionale është kur plagët tona nuk na bëjnë më të ashpër, por më të dhembshur. Kur ajo që kemi përjetuar nuk na mbyll ndaj botës, por na ndihmon të kuptojmë më mirë dhimbjen e tjetrit. Në fund, pyetja më e rëndësishme nuk është vetëm: "***Ku shkoj më shpesh***?" Por: **"Çfarë po ushqen mendjen, zemrën dhe shpirtin tim çdo ditë?"** Çfarë vendi jam unë për njerëzit që kalojnë në jetën time?" Sepse vendet që zgjedhim të frekuentojmë, njerëzit me të cilët rrethohemi dhe mendimet që kultivojmë bëhen gradualisht pjesë e asaj që jemi. Ndoshta në fund të rrugëtimit tonë, nuk do të kujtojmë vetëm vendet ku kemi qenë, por vendet ku kemi gjetur paqe. Nuk do të na përcaktojnë vetëm kilometrat që kemi përshkuar, por drita që kemi ndërtuar brenda vetes dhe tek të tjerët. Sepse vendi më i rëndësishëm që një njeri mund të krijojë nuk gjendet në hartë. Ai ndërtohet çdo ditë, me zgjedhje të vogla: me një fjalë të mirë, me një çast heshtjeje, me një akt faljeje, me një dorë të shtrirë drejt tjetrit. Kur zemra bëhet një vend ku banon paqja, njeriu nuk ka më nevojë ta kërkojë dritën kudo. Ai bëhet vetë dritë. Dhe ndoshta kjo është forma më e lartë e shërimit: të jetosh në mënyrë që prania jote të bëhet vendi ku dikush tjetër gjen shpresë.

Traditatat e të qethurve të deleve në Stankaj - RUGOVË

REPORTAZH NGA RUGOVA

Profesor Tahir Brezhani

Rugova është njëra ndër krahinat më të njohura të gjeografisë shqiptare ku ruhen më së miri traditat dhe kultura jonë kombëtare. Rugovasit në radhë të parë i karakterizon bujaria, fisnikëria, trimëria dhe ndershmëria. Rugovasit i kanë dhënë burra e trima këtij vendi në mbrojtje të lirisë, atdhetarë të spikatur ndër shekuj. Veshja kombëtare paraqet kulmin e traditës dhe kulturës sonë së bashku me këngët, vallet, lojërat e të tjera tejet artistike.

Ndonëse të shkapërderdhur nepër vende të ndryshme nga kushtet e vështira të kohëve, duke marë boten në sy për një jetë më të mirë, megjithatë, kohëve të fundit janë rikthyer disa prej tyre dhe kanë filluar jetën në trojet e tyre së bashku me traditat dhe mirësitë që i karakterizojnë këta banorë të vyer.

Fshati Stankaj i Rugovës, jep shembullin më të mirë për të rikthyerit dhe të jetës së rehatshme në vendlindjen e tyre, ku ruhen me xhelozi traditat tona, të kësaj krahine famëmadhe.

Vëllezërit Naser e Halil Ukë Kurtaj, këto ditë dëshmuar dashurinë për vendlindje dhe për traditat tona të çmuara. Këta dy vëllezër, me 4.korrik, organizuan ceremoninë e të qethave të deleve si një nga traditat e këtij vendi prej kohësh. Tufa e deleve të tyre prej 250 krerësh, hijeshon shpatet e bjeshkëve në kullosa . Blegërima e qingjeve të rikujton "Bagëti e Bujqësi" të Naimit romantik. Nuk mungon as kënga e fyelli shpateve të fshatit Stankaj.

Për këtë festë të qethurave, vëllezërit Kurti kishin ftuar me pa rreth 100-150 veta, shokë e miq, e mes tyre edhe zyrtarë të pushtetit Qendrorë e lokal, nga Ministria e Bujqësisë dhe pylltarisë, si bashkë organizatorë të kësaj tradite në Rugovë të Pejës. Mori pjesë këshilltari i resorit të Bujqësisë e pylltarisë, nga Peja, z. Mehdi Mulaj, i cili, me fjalët e tij kurajuese, falënderoj fermerin Kurtaj për organizimin tradicional të Rugovës, ruajtjen e traditave dhe zgjerimit të kësaj veprimtarie dobiprurëse. Premtoj bashkëpunim dhe ndihmë në këtë lami, me qëllim të zgjerimit të tufave të deleve në bjeshkët e Rugovës. Ndërkaq, banorët dhanë disa mendime e sugjerime, me qëllim të plotësimit të nevojave të tyre për kultivimin e fermave të blegtorisë në këto bjeshkë të bukura.

Njëri nga biseduesit iu drejtuar: z. Mehdi; "Në fshatin Stankaj mbaj mend 3000 dele, që kullosnin këto shpate, ndërsa tani, vetëm 250 krerë ka fshati. Mos të përmend edhe fshatrat tjera, që kishte mbi 5000 krerë dele. Andaj, na si banorë të këtij vendi kërkojmë ndihmën e pushtetit lokal e Qendrorë, për ndihmë sa më të arsyeshme.

Folesi tjetër përmendi si problem Parkun Nacional, i cili ka kufizuar hapësirën për kullosa delesh..."

Rapsodët nga Shqipëria dhe Hysen Kuerti nga Stankaj- Rugove, me lahute luar dhe të etur për vendlindjen e tyre, leviznin, nuk u xinte vendi vend nga kënaqësia, u qeshte fytyra dhe incizonin programin e pasur e të organizuar për mrekulli nga mikpritja e vëllezërve Kurtaj të fshatit Stankaj.

Një moment të veçantë e të paharruar këtij manifestimi ia shtoi rapsodi, tani i mirënjohur anekënd trojeve shqiptare, lahutari, Hysen Kurti, i cili me veshje kombëtare, "zbarkoi" nga hoteli "Kulla e Rugovasit" si një shqiponjë, veshur në kostume kombëtare të Rugovës, duke ia thënë bukur këngës majëkrahut, i cili u prit me duartrokitje të gjata.

Pastaj, në ecje e sipër, si një aktor i vërtetë, ofrohej pjesëmarrësve, duke recituar vargje nga Fishta, vargje për Vraninen. Nga ajo atmosferë madhështore, dukej se edhe pishat e gjata po këndonin me këtë malësorë të Rugovës, i cili kudo që qëllon ndezë atmosferë e gëzim. Nuk mungoj as vallja e njohur e burrave të Rugovës, një valle e njohur anekënd botes për traditën dhe koreografinë të shqiptarisë.

Pas kësaj ceremonie, këshilltari i sektorit të Bujqësisë nga pushteti lokal në Pejë, ndau disa mirënjohje për organizatorin (mikpritësin) dhe disa të tjerë, si motivim e nxitje për vazhdimin e traditave tona dhe zgjerimin e fermës së blegtorisë në këtë fshat dhe tjerat për rreth.

Bujaria rugoviane është e njohur anekënd trojeve tona. Pos që të hapin zemrën e bujarisë, ata shtrojnë tryezën me gjitha të mirat që ka shtëpia.

Për fillim, miqve të ftuar iu shërbyen me përshesh me tambël të deleve i cili ka shije të këndshme. Në radhe, pas një pauze, shtruan tryezën e gjatë për të pranishmit me të gjitha llojet e ushqimeve vendore, duke filluar me pjatat me djathë cilësorë, mish qengji të pjekur, leqenik, flija, ëmbëlsira, ku secila ishte më e shijshme se tjera. Të pranishmit shërbeheshin sipas dëshirës së tyre, me ato të mira të shtruara në tryezën e gjatë.

Në një ambient të këndshëm bjeshkor, nën përkundjen e flladit të pishave, me pije të llojllojshme e ujë bjeshke, secili ngopjen në dy aspekte: me ajrin e pastër, pamjet dhe ushqimet e mrekulluara vendore të Rugovës.

Të gjitha ushqimet e ofruara për miqtë, ishin përgatitur nga familjaret e mikpritësit. Për kureshtje të këtyre specialisteve tregova interesim të dija për gatimet. Zymer Kurti nuk hezitoj, dhe me dërgoj në kuzhinën ku bëhej gatimi. Me njoftoj me nënën Cubë, Cube Kurtin, e moshës 86 vjeç, e njohur në tërë Rugovën, për çdo lloj gatimi. Ajo ishte ulur në një karrige dhe përziente mazën e zier, njëri nga specialitet më të kërkuara në menynë rugoviane. Të rejat e shtëpisë e dëgjonin dhe përfillnin me vëmendje porositë e saja. Një trashëgimi ndër breza, sa mrekulli!

Ora kishte kaluar katër pasdite. Flladi i mbrëmjes kishte ndërruar melodinë, ishte më i ashpër. Pishat luhateshin dhe lëshonin aromë të këndshme, sikur donin të na tregonin për ikjen e një dite të këndshme në fshatin Stankaj, miqtë në të qethurat e deleve të mikpritësve, Naser e Halil Kurti nga ky fshat. U ndamë duke u përshëndetur ngrohtësisht me falënderimet për ftesën, duke iu dëshiruar shëndet e suksese në zhvillimin e fermës së deleve dhe ruajtjen e traditave aq të pasura vendore.

Sa gjatë ngelet në mendje të njeriut një ditë e kalendarit të jetës kur përjetohet me aq ngrohtësi!...

Stamkaj - Rugovë,
me 5 korrik 2026

Ferma e blegtorisë së Naser e Halil Kurtaj, është bërë e njohur edhe për produktet e qumështit dhe mishin cilësore të qingjeve të tyre. Nga këto produkte edhe fitimet janë të lakmuara.

Pse jemi shoqëri kaq e dhunshme dhe e kriminalizuar?

BASHKËBISEDIM ME SOCIOLOGUN GËZIM TUSHI, MJESHTËR I MADH DHE KALORËS I URDHËRIT TË SKËNDERBEUT

Bashkëbisedoi,
Fran Gjoka

Situata sociale në Shqipëri duket disi e tronditur nga një seri krimesh që po ndodhin pothuajse çdo ditë. Si mendoni Ju për këtë gjendje? Cilat janë shkaqet e kësaj situate?

Është e vërtetë që ka kohë që situate sociale në shoqërinë shqiptare është tronditur ekzistencialisht nga përmasat e zgjeruara dhe gjithnjë në rritje të krimit, fenomen social që ka kapur të gjitha institucionet bazë të shoqërisë, strukturat e autoritetit social dhe institucionet themelore të qytetërimit tonë. "Limfa" e krimit është bërë gati si buka e përditshme për ne. Madje duket sikur ka edhe një proces paradoksal të adoptimit të shoqërisë me këtë nivel të lartë të kriminalitetit.

Ontologjia dhe fenomenologjia e krimit është bërë banale dhe e sofistikuar. Ajo ka të tërë gamën e njohur të kriminalitetit nga ai banal e për motive të dobëta deri tek tendencat për shfaqjen e krimit të organizuar dhe inicimin e organizatave kriminale. Një fenomen, që nga pikëpamja gjeografike, është pothuaj e ndodhur kudo: në zonat urbane e qytetet metropolitan, në zonat periferike periurbane e rurale, në familje e shkollë, në jetën publike e sjelljet komunitare. Dukuria e kriminalitetit, qoftë nga pikëpamja moshore apo gjinore gjithashtu, është tejet prezent. Të përfshirë në këtë veprimtari janë burra e gra, të rinj, madje nga ky infeksion social kanë filluar të mos jenë të imunizuar as fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë. Ulja e moshës së fillimit të veprimeve kriminale, sikurse ishte rasti i ngjarjes makabre në ambientet e shkollës "Fan Noli" është bërë shqetësues.

Shkaqet e kësaj situate kërkojnë diagnostikime të gjëra, komplekse dhe shumëdimensionale, sepse ato janë shkaqe të ndërlikuara, të përziera, sintetike dhe sinkretike. Megjithatë sociologjia e krimit në kuptimin e përgjithshëm social apo edhe mikrosociologjia e shkaqeve të kapilarizuara në jetën e institucioneve apo të personalizuara me individë të caktuar, të përfshirë në botën e erët të krimit, dëshmojnë se ky zgjerim i aktivitetit kriminal, ky nivel i akseleruar i dhunës sociale ka shkaqet e veta, me natyrë historike, kulturore, edukative, shoqërore dhe individuale.

Sipas mendimit tim, krimi në shoqërinë tonë është i lidhur me shumë faktorë të brendshëm dhe të jashtëm,

sidomos me problemin e situatës së destabilizuar të institucioneve kryesore të autoritetit social dhe sigurisë morale. Ka një dobësim të dukshëm të "makinerisë edukative" që ka role formuese e parandaluese për formimin qytetar. Në këtë kontekst është reduktuar roli i strukturës së familjes në procesin e edukimit, është reduktuar koha dhe cilësia e prindërimit në marrëdhëniet e prindërve me fëmijët, nën pretekstin e angazhimeve jashtë familjare. Po ashtu dëmtime serioze në aspektin e edukimit ka pësuar edhe shkolla, si institucioni më autoritar për formimin qytetar të brezit të ri, si mekanizmi që ka të gjitha mundësitë t'u mësojë fëmijëve, adoleshentëve dhe të rinjve mënyrat e sjelljes jo agresive e kriminale, por rrugën humane të zgjidhjes së kontradiktave dhe konflikteve të natyrshme nëpërmjet komunikimit, tolerancës, mirëkuptimit, etj. Të gjitha këto mekanizma kanë nevojë të ridimensionojnë punën e tyre, sepse ato janë institucionet themelore e influente që mund të ndikojnë në edukimin qytetar dhe parandalimin e krimit.

Padyshim, në këtë situatë, ka përgjegjësinë e vet edhe shteti bashkë me strukturat e veta të drejtësisë, policisë dhe ndëshkimit të krimit. Asnjë toletrancë nuk i duhet bërë krimit. Ndëshkimi i kriminelëve është kusht për të vënë në vendin e duhur shtetin ligjor.

Vritet një fëmijë adoleshent, 14 vjeçar, në mes të rrugës, pranë shkollës. Si e shikoni këtë moment: rastësi apo ndikim negativ nga rrjetet sociale, mosfunksionim të familjes në procesin e edukimit, neglizhencë e shkollës, paaftësi dhe mungesë përgjegjësie e sistemit të edukimit dhe të mbrojtjes së fëmijëve nga ana e mësuesve, oficerit të sigurisë, shërbimit psiko-social në shkollë apo çfarë?

Pa dashur që shkollën ta bëjmë "kokë turku" dhe t'i shkarkojmë tërë përgjegjësitë dhe mangësitë e integruara të gjithë makinerisë edukative, duhet të pranojmë se pas kësaj ngjarje dhe shumë ngjarjeve të tjera të akteve të dhunës dhe krimit midis dhe ndërmjet adoleshentëve, është edhe shkolla si institucion dhe mësuesit si aktorë kryesorë të saj. Ngjarjet skandaloze të dhunshme e kriminale që kanë ndodhur në shkollat tona e shtrojnë si detyrë imperative ndryshimin dhe përsosjen e ndikimit të mekanizmave social-psikologjikë e pedagogjikë të edukimit, sepse shkolla nuk duhet konsideruar vetëm si institucioni kryesor i dijes, por mbi të gjitha si institucioni themelor i edukimit qytetar, sepse në shkollë nxënësit dhe adoleshentët jo thjesht vetëm shkollohen, por aty edukohet si njeri që ka mundësi të zgjedhë rrugën e duhur të jetës.

Për t'i mësuar fëmijët dhe adoleshentët se si të gatuajnë "supën e jetës" duhet të funksionojnë të "dy kuzhinat" edukative: familja dhe shkolla. Shkolla ka të gjitha mundësitë e plotësimit të dy detyrave themelore të misionit të saj institucional dhe eduktiv, duke kombinuar luftën për formimin intelektual përmes dijeve mësimore, por e kombinuar kjo edhe me vetëzhvillimin e drejtuar të adoleshentëve. Duhet shkundur shkolla nga situatat rutinore dhe indiferenca edukative, duke përmirësuar sa më shumë të jetë e mundur kuotat e komunikimit empatik dhe bashkëpunimin e frutshëm, me efiçiencë edukative në marrëdhëniet e tyre me adoleshentët. Nxënësit kanë nevojë për horizont kulturor, po aq, në mos më shumë se sa për horizont shpirtëror dhe qytetar. Nuk ka pse të na vijë keq, besoj se në shumë raste në shkolla puna edukative ose është e përciptë, pa shpirt dhe empati ose është "veprimtari e lodhur". Është e vërtetë që shkolla po përballet me furitë, turbulencat, rebelizmin dhe shfaqje të anarkisë moshore, sepse adoleshentët e kohës sonë janë të përbërë nga tjetër "materie sociale". Kjo është arsyeja e tronditjes së mësuesve dhe e marramendjes së shkollës.

Padyshim ndikimi i gjendjes së shoqërisë tonë, ka ndikimet e veta në punën, sukseset apo difektet e shkollës, sepse ai është institucion i "interferuar" dhe jo i izoluar nga ndikimet pozitive apo influencat patologjike e toksike të shoqërisë shqiptare. Në këto rrethana duket që jo vetëm familja, por dhe koha është në "kohë të vështirë" për të përmbushur kërkesat edukative dhe deontologjike të saj. Situatat që kalon shkolla në marrëdhëniet me adoleshentët nuk kërkon trajtime "en block" të problemeve, konflikteve dhe ballafaqimit me adoleshentët, as diagnostikime të përgjithshme statistikore apo burokratike. Shkolla ka nevojë për diagnostikime kapilare e të personalizuara të çdo adoleshenti, të tipologjisë dhe fenomenologjisë së shfaqjeve. Këtë mund ta bëjnë vetëm mësues me personalitet dhe integritet.

Përse jemi një shoqëri kaq e dhunshme, një dhunë e futur kaq thellë, deri në familje, deri në moshat e vogla? Cilët mund të jenë faktorët që ndikojnë sot në këtë drejtim?

Po, është e vërtetë që kohët e fundit sidomos shoqëria shqiptare po përballet me nivele të larta të dhunës, në të gjitha format e mundshme të saj, që nga ato antiqytetare e deri në akte të bujshme kriminale. Për fat të keq, dhuna në familje është në zgjerim. Sidomos kjo e shkarkuar padrejtësisht

mbi gratë dhe fëmijët.

Në fakt u bënë tri dekada e gjysmë që në shoqërinë tonë përditë, në mënyrë të vazhdueshme, po përballemi me forma të llahtarshme të krimit, tipologji të tilla të sjelljes së përbindshme, që jo vetëm e kanë bërë atë fenomen social shumë intensiv, por akoma më keq, është bërë dukuri që synon të krijojë në shoqërinë tonë klimën e adoptimit social, herë në mënyrë lineare e paqësore e herë të tjera të detyruar e me dhunë sociale, praninë dhe pranimin e kësaj të keqeje të madhe, këtij shqetësimi të përbashkët për individin dhe shoqërinë shqiptare në tërësi. Paradoksalisht me kalimin e kohës, situata e krimit është ekzagjeruar keq.

Në mënyrë të sintetizuar, duke vlerësuar objektivisht e sociologjikisht fenomenin, duhet pranuar se situata e krimit të organizuar dhe ordiner në Shqipëri është tejet e zymtë. Në se këtë analizë sociale dhe sociologjike do ta bëjmë drejt, objektivisht, pa subjektivizëm dhe njëanshmëri, mund të themi se të duket sikur burimet e krimit janë në përmasa të tilla, që e bëjnë të dyshimtë ecjen tonë drejt progresit social, realizimit të normave europiane dhe standardeve sociale të qytetërimit postmodern.

Besoj se duhet të "zgjohemi" nga gjumi social dhe të kuptojmë se në totalin e vet, krimi në shoqërinë tonë ka bërë që situata të jetë e tillë, nga që sasia e kriminelëve dhe cilësitë e krimit janë bërë të tilla, që kanë filluar të gërryejnë "muret e ekzistencës" dhe funksionimit normal të organizimeve kryesore të jetës sociale, familjes, qytetit, komuniteteve dhe shoqërisë shqiptare në tërësi, duke vënë në rrezik serioz modalitetet e ndërtimit të marrëdhënieve njerëzore, sigurimin e kushteve të duhura të funksionimit të paqes sociale në Shqipëri.

Ajo që është tejet shqetësuese në këto momente, që duhet të na bëjë të mendojmë mirë, lidhur me shkaqet dhe situatën e përhapjes masive të krimit, janë shfaqjet e një lloj qëndrimi pajtues, konformist të shoqëruara më një indiferencë sociale, pajtueshmërie pasive. Kjo përbën rrezik pse është një mënyrë e rafinuar, për të na bërë të përshtatemi me praninë e krimit në jetën e përditshme, duke e patur gjithnjë pranë dhe afër nesh, madje pa shumë shqetësim social të lloj-lloj krimeve dhe kriminelëve që i kryejnë ato.

Kultura e pasivitetit, e pajtimit indiferent me këto situata, është njëri nga shkaqet madhore të përhapjes intensive dhe ekstensive të krimit në shoqëri. Sondazhet sociale tregojnë se niveli social i kuptimit dhe reagimit social ndaj krimit në shoqërinë tonë, është tmerrësisht i ulët. Ky është faktori që po favorizon përhapjen dhe zgjerimin e tij në familje, shkollë, ambiente publike, komunitet e kudo. Duket dhe ka një perceptim publik, që tregon se strukturat e shtetit dhe reagimi social, po bëhen të pafuqishme përballë ligësisë së krimit. Kjo është një situatë që duhet përballuar. Sepse krimi jo vetëm ndikon në "shqepjen e tegelave" të shoqërisë, por ndikon edhe në shfaqjen e "krisjeve sociale" të unitetit të shoqërisë përballë të keqes personale dhe ligësisë sociale…

Mos vallë institucionet demokratike e kanë humbur besimin tek njerëzit apo këto institucione nuk janë të afta të veprojnë apo të gjejnë mënyrat e duhura për t'i parandaluar, jo me forcë, por me veprime dhe ligje inteligjente që njerëzit të bëhen të vetëdijshëm për të mos përdorur dhunën si zgjidhje?

Ka kohë që paradoksalisht në shoqërinë shqiptare po qarkullon gjerësisht ideja e zgjidhjes së problemeve me forcë dhe ideja e krijimit të "njeriut të fortë". Kjo "limfë ideologjike" shumë e përhapur dhe toksike ka kapur individë, madje edhe grupe sociale e shtresa të gjëra të shoqërisë tonë. Madje ky është një nga shkaqet pse dhuna, bullizimi dhe krimi me gjak të ftohtë po shfaqet edhe në konfliktet dhe rivalitetet moshore të adoleshentëve. Edhe aty po shfaqet "fantazma" e njeriut të fortë dhe e përdorimit pragmatist të dhunës për të qenë "dikushi" në grup apo i afirmuar si "i forti" i klasës apo shkollës.

Sigurisht situata është e lidhur me shumë faktorë historikë, kulturorë, social, të traditës së familjes patriarkale e paternaliste, me "abortin" edukativ të përpjekjes së dështuar gjysmëshekullore për krijimin e "njeriut të ri", etj. Por tani situata është agravuar, nga që janë tkurur, rrudhur, indiferentizuar institucionet kryesore të "autoritetit" dhe sigurisë sociale.

Sociologët evidentojnë si shkaktare të situatës faktin që shoqërive të sotme po i "shqepen tegelat" social nga që ka një rënie progresive të autoritetit edukativ të familjes dhe shkollës, por dhe dobësim të veprimit të drejtësisë ligjore, parandaluese dhe ndëshkuese të organeve të shtetit, për të ndëshkuar pa hezitim krimin dhe për të bërë "zap" kriminelët, të cilët po tentojnë të formojnë grupe sociale për t'iu kundërvënë institucioneve të shtetit, ligjeve dhe shoqërisë. Në këto rrethana shoqëria ka nevojë për një strategji të integruar, polivalente e shumë faktoriale për të bashkuar në një strukturë kompakte të gjithë faktorët, aktorët dhe institucionet për të rregulluar ekuacionin e duhur ekzistencial për të përballur këtë valë të zgjeruar të kriminalitetit.

Sigurisht, duke rregulluar metafizikën dhe funksionin komplementar të institucioneve të edukimit dhe parandalimit me ato të drejtësisë dhe ndëshkimit ligjor. Kjo është ajo që presin qytetarët dhe shoqëria shqiptare, si mënyra e vetme për të zbutur intensitetin e krimit në shoqërinë tonë.

Gjuha e politikës, dhuna në institucione, a mos janë disa nga shkaqet që ndikojnë negativisht në gjithë ambientin social dhe deri në familje?

Padyshim, politika ka përgjegjësitë e veta në këtë situatë të agravuar të krimit në shoqërinë tonë. Politika, politikanët dhe ata që janë në "bordin e shoqërisë" dhe që kanë detyrën dhe përgjegjësinë e administrimit të situatës sociale, shumë shpesh janë faktorë të nxitjes së intolerancës politike, agresivitetit konkurencial, dhunës verbale, psikologjike e fizike, duke i kthyer ato paradoksialisht në mjete aspak adekuate të luftës politike midis palëve alternative e kundërshtare politike.

Gjuha e drujtë, akuzat e pabazuara, replikat formale pa substancë dhe si qëllim në vetvete, janë faktorë që nxitin zgjerimin e neurotizmit social në jetën shoqërore, me ndikim edhe në komportimin psiko-social të njerëzve tanë në familje, shkollë dhe jetën shoqërore. Politika ka mëkatet e veta në këtë situatë. Ajo duhet t'i njohë përgjegjësitë e veta dhe të bëhet "ilaçi i duhur" për të ndihmuar përmirësim, pse jo edhe shërimin e plagëve të dhunës dhe kriminalitetit në shoqëri. Në këtë kontekst, edhe institucionet fetare, media dhe shoqëria civile kanë rolin dhe përgjegjësitë e tyre. Të gjithë si individë, si shoqëri dhe bashkë me institucionet sociale, jemi përballë një beteje të madhe qytetare dhe qytetëruese për t'u përballur qytetarisht me dhunën dhe krimin. Kjo kërkon struktura të integruara, kohezive, bashkëpunuese e kompakte për të bërë të mundur zbutjen e agresivitetit social, shëndoshjen e institucioneve të edukimit dhe harmonizimin e interesave midis individit, familjes, shkollës dhe shoqërisë.

95 - vjetori i krijimit të Mbrojtjes Kundërajrore në Republikën e Shqipërisë



N/kolonel Ndue Marku,
ish komandanti i Regjimentit kundërajrorë, në Divizionin e Shkodrës

Me datën 1 korrik 2026, shoqata "Skënderbe" - dega Shkodër, në bashkëpunim me Shoqatën e ushtarakeve në lirim e në Pension (AKUSH) organizuan përkujtimoren e kësaj arme me veçori të veçanta në Forcat e Armatosura Shqiptare,

Cili është historiku i shkurtër kësaj arme?

Me nisjen e fluturimit të pare të avionit në vitin 1903, nisen përpjekjet për të krijuar arme kundër tij, kundër avionit.

Procesi i zhvillimit të armatimit dhe teknikes të Mbrojtjes Kundërajrore (MKA)-se ishte i njëkohshëm me atë të aviacionit luftarak.

Në Shqipëri avioni i pare luftarak armik u rrezua me 23 Korrik 1920, në fushën e Peshkepise Vlore. Ushtaraku i pare që studioi për artileri Kundërajrore, në Akademinë Ushtarake të Stambollit nga Shqipëria ishte Abdurrahman Ali Çiraku nga Verrniku Vlorës.

Me 1 korrik 1931, plot 95 vite më pare, me dekret të Mbretit Ahmet Zogu të Shqipërisë u përhapën në pozicione zjarri tre bateri kundërajrore, në mbrojtje të porteve Shëngjin, Durrës dhe Sarande. Me vendim të Këshillit Ministrave të Republikës Shqipërisë, kjo është caktuar data e krijimit MKA të Shtetit Shqiptar. Në fund të vitit 1944, me largimin e pushtuesve nga vendi, gjermanet lanë në territorin shqiptar disa topa kundërajror të kalibrit 20 mm dhe 25 mm, të cilët u grumbulluan në fshatin Karpën - Kavaje. Në fillim të vitit 1945 bateritë e para me topa kundërajrorë u vendosen në Kuçovë, Tirane, Durrës dhe Korçë. Nga viti 1945 deri në vitin 1990, MKA u zhvillua, u fuqizua, u masivizua dhe u organizua në gjithë territorin e vendit, me teknike kryesisht të prodhimit rus dhe kinez.

Me 14 Maj të vitit 1945 u krijua Komanda e MKA të Forcave të Armatosura të Shtetit Shqiptar. Komandanti i pare i MKA ishte gjeneral Gjin Marku, me zëvendës për AKA, kolonel Maqo Zoto dhe zëvendës për aviacionin, kolonel Edip Ohri.

MKA e Forcave te Armatosura të Shqipërisë kreu me sukses misionin e ngarkuar për mbrojtjen e vëzhgimin e hapësirës ajrore të vendit, që rrezikohej nga kundërshtarët tanë. Ajo kishte teknike luftarake të kohës, efektiva të përgatitura, të cilat realizuan me sukses detyrat, në gjithë territorin e vendit. Ndryshimi i sistemit politik në vitin 1990 e gjeti MKA me ketë përbërje organike:

- 24 Regjimente të Artilerisë Kundërajrore.
- 4 grupe të Raketave të Drejtuara Kundërajrore.
- 72 Radarë të Zbulimit të Largët.
- 102 Grupe të Artilerisë Kundërajrore, të kalibrave të ndryshme,
- 590 Bateri të Artilerisë Kundërajrore të kalibrave 100mm, 85mm, 57 mm dhe 37mm,
- 570 toga me mitraloza kundër ajrore 12.7mm.

Pas vitit 1990 ky arsenal armatimi dhe teknike luftarake, si pasoje e ndryshimeve politike, reformave demilitarizuese në bashkëpunim me aleatet strategjik dhe strukturat e NATOS u nxorën jashtë përdorimit. Aktualisht vëzhgimi dhe mbrojtja e hapësirës ajrore të RSH u është besuar partnereve tanë në NATO, Italisë dhe Greqisë.

Sistemi i deriatëhershëm i zbulimit ajror, kontrollit të hapësirës ajrore, kushtrimit ajror dhe kundërveprimit të mbrojtjes kundërajrore doli jashtë funksionit.

Gjeneratat, që shërbyen me përkushtim dhe shkrinë jetën në strukturat e MKA i karakterizonte dashuria për atdheun, duke bere që misionin e ngarkuar ta realizonin me sukses.

Pjese e rëndësishme e MKA ishin Raketat e Drejtuara Kundërajrore.

Në vitin 1953 aleati i vendit tone në atë kohe BRSS filloi prodhimin e Raketave Kundërajrore. Menjëherë, Komandanti i MKA gjeneral Gjin Marku i paraqiti në udhëheqjen e larte argumentet perse vendi ynë duhej të armatosej me raketa kundërajrore.

Kërkesat u pranuan dhe u dërguan në Bashkimin Sovjetik oficeret e pare për specializim të zgjedhur nga radhët e efektivave të Artilerisë Kundërajrore.

Në Shqipëri Raketat e Drejtuara Kundërajrore u sollën në vitin 1960. Me 28 Nëntor 1960 u vendosen në pozicione zjarri në e Grecës të Tiranës - Grupi i pare i Raketave të Drejtuara Kundërajrore. Me 17 Janar 1961 u vendos në pozicione zjarri Grupi i dyte i Raketave të Drejtuara Kundërajrore në rajonin e Sukthit - Durrës.

Në vitin 1968 në kuadrin e marrëdhënieve të mira politike ushtarake dhe tregtare me Republikën e Kinës, u sollën nga Kina edhe dy grupe të tjera Raketash të Drejtuara Kundërajrore.

Kështu, që Grupi i trete i RDKA u vendos në Kruje, ndërsa Grupi i katërt i RDKA u vendos në Patos. Me 6 Dhjetor 1968 u krijua Regjimenti i Raketave te Drejtuara Kundërajrore, me katër grupe raketash. Me 29 Nëntor të vitit 1969 raketat u shfaqen për here të pare ne publik në Paradën ushtarake, me rastin e 25 vjetorit të çlirimit të atdheut.

Edhe këto raketa u nxorën jashtë funksionit, në kuadër të reformave, duke u zëvendësuar me raketa kundërajrore, që mbahen në supin e ushtarit dhe me drojet e llojeve të ndryshëm.

Pas vitit 2000 Forcat Ajrore filluan e pajisen me teknike fluturuese perëndimore.

Në Prill të vitit 2001 erdhën helikopterët e pare AB-206, për të vijuar në Nëntor 2003, që plotësohet skuadrilja.

Me 24 Prill 2004 erdhi helikopteri i pare AB-205.

Me 1 Shkurt 2007 erdhi helikopteri i pare i transportit VIP A-109.

Me 18 Qershor 2007 erdhën helikopterët e pare BO-105.

Me 28 Korrik 2012 erdhi helikopteri EC-145 i versionit VIP.

Me 3 Dhjetor 2012 erdhi helikopteri i pare shumë funksional tip Cougar, me 25 Prill 2013 erdhi i dyti, me 18 Dhjetor erdhi i treti dhe me 27 Tetor 2014 erdhi i katërti Cougar.

Me 31 Tetor 2015 hyjnë në përdorim të flotës ajrore të RSH dy helikopterë EC-145.

Këto janë disa të dhëna në vijimësi nga fillesat e para deri në ditët e sotme për mjetet fluturuese ajrore dhe kundërajrore të përdorura nga Ushtria Shqiptare.

Duke qene se ne jemi vend anëtar i NATO-s mbrojtja e vendit tone është pjese e mbrojtjes kolektive. Shteti Shqiptar programon dhe planëzon stërvitje dhe pajisje luftarake të përbashkëta me vendet aleate.

Një zbulim i veçantë!

Gjyste Gila - Shyti

Një grup alpinistësh të huaj që po eksploronin shtigjet e paprekura në Alpet Shqiptare ka sjellë një zbulim të papritur që po kthehet në temën kryesore të diskutimit mes gjeologëve dhe biologëve.

Gjatë ngjitjes në një masiv shkëmbor të izoluar pranë fshatit Theth, ata vunë re një çarje të ngushtë në gurtë e mbuluar nga bimësia e dendur.

Pasi arritën të hynin në brendësi me pajisje speciale drite, ata zbuluan një rrjet të tërë shpellash të egra që fshinin një mikroklimat krejtësisht unik dhe të paprekur nga bota e jashtme.

Ajo që i habiti më shumë gjeologët që vizituan zonën menjëherë pas sinjalizimit, ishte ekzistenca e një liqeni të vogël nëntokësor me ujë jashtëzakonisht të pastër dhe të pasur me minerale të rralla. Rreth këtij burimi u pikasën formacione kristalore që shkëlqejnë në errësirë dhe që kërkojnë kushte specifike atmosferike dhe izolim shekullor për t'u krijuar në atë formë perfektë.

Ky zbulim nuk është thjesht një ngjarje e bukur natyrore, por një kapsulë e vërtetë kohe që tregon se si nëntoka e Alpeve tona fsheh ende sisteme të tëra ekologjike të panjohura.

Përveç vlerës gjeologjike, specialistët e mjedisit po analizojnë mostrat e para të ujit për të parë nëse ky burim i fshehur ka lidhje me rrjetet e mëdha ujore që furnizojnë luginat përreth.

Tashmë po kërkohet me ngulm që kjo shpellë e re të shpallet zonë e mbrojtur rreptësisht nga shteti, për të parandaluar çdo ndërhyrje apo eksplorim të pakontrolluar që mund të dëmtojë këtë ekuilibër të rrallë natyror.

Ky udhëtim i nisur si një aventurë e thjeshtë malore po kthehet në një nga dëshmitë më të fuqishme të pasurisë së fshehur natyrore të vendit.

Lisi që u tretë në heshtje

ESE ELEGJIAKE PËR PËLLUMB LULASH SOKOLIN

Nëpër viset alpine të Shoshi, ku burrat maten me hijen e maleve dhe fjala ruhet si amanet, jetoi e u rrit një nga filizat më të hijshëm të brezit të vet: Pëllumb Lulash Sokoli. Ai erdhi nga një familje e denjë, me tradita atdhetarie e burrërie, ku nderi dhe fjala e drejtë ishin më të çmuara se çdo pasuri tjetër. Fëmijëria e tij u rrit mes vështirësive të kohës, por edhe nën një edukatë të fortë familjare që i mësoi nderin, mirësjelljen dhe përmbajtjen. Qysh i ri dallohej për zgjuarsi e përkushtim. Ishte nxënës i shembullor, me një kaligrafi të rrallë dhe me prirje të natyrshme për matematikën. Librin e kishte mik të hershëm dhe të qëndrueshëm, një mik që nuk e braktisi asnjëherë gjatë jetës. Por jeta, shpeshherë, nuk i hap udhët sipas meritës. Kushtet ekonomike të kohës nuk e lejuan të largohej nga familja për të ndjekur shkollën larg krahinës. Arsimin e mesëm e mori duke mos u shkëputur nga puna dhe nga detyrimet familjare, duke dëshmuar se njeriu i fortë nuk e mat veten me lehtësitë, por me qëndresën.Në rininë e tij ishte aktivist dhe veprimtar i gjallë. Ai u bë pionier i hekurudhës dhe aksioneve kombëtare të rinisë, organizator dhe drejtues grupi në punë kolektive. Kishte aftësinë e rrallë për të bashkuar njerëzit dhe për t'i bërë të ndiheshin pjesë e një qëllimi të përbashkët.Më pas jeta e çoi në përgjegjësi të tjera Punoi në nivele drejtuese në bujqësi e blegtori, ndërsa për një dekadë e gjysmë shërbeu si drejtues i pushtetit popullor në bazë. Në kohën kur pluralizmi i parë po trokiste edhe në viset e Dukagjinit, ai u bë sekretari i pushtetit të parë pluralist të Shoshit ,një detyrë që kërkonte maturi, drejtësi dhe urtësi. Për më shumë se tridhjetë vite punoi si kuadër me ndershmëri, seriozitet dhe përkushtim. Kandari i tij anonte gjithmonë nga e drejta dhe nga hallet e njerëzve në nevojë. Nuk u përkul as para interesave, as para servilizmit, as para intrigave të kohës. Ishte nga ata burra që e mbajnë drejt shtyllën e karakterit edhe kur era fryn kundër.Në vitet më të vështira të krizës ekonomike të kooperativës, kur shumëkush humbiste durimin dhe rrugën, ai bëri më të mirën e mundshme. Nuk i bëri askujt keq , edhe kur mund ta bënte "me tonelata", siç thoshte populli. U përplas me drejtues dallaverexhinj, por nuk u përkul. Asgjë veç djersës së ballit nuk çoi në shtëpinë e tij. Me të njëjtën ndershmëri krijoi familjen dhe rriti fëmijët sipas modelit të vet: me punë, me drejtësi dhe me nder.Pas viteve nëntëdhjetë qëndroi larg politikës. Nuk shau askënd, nuk mallkoi askënd, nuk nxori mellef nga goja për askënd. Ishte një burrë inteligjent, që dinte të debatonte në çdo mexhlis popullor e intelektual, por gjithmonë me urtësi e respekt.Ai ishte njohës dhe trashëgues i traditave më të mira të vendit të vet. I qeshur, i dashur dhe i vetëpërmbajtur. Kurrë nuk fliste pa e peshuar mirë fjalën. Gjuha e tij nuk hodhi kurrë shigjeta helmuese. Pëllumbi ishte edhe shijues i jetës. I donte stinët, bisedat, miqtë. Dinte të fliste me të rinjtë dhe me të moshuarit, sepse në shpirt mbante një qetësi të rrallë.Nuk u tundua nga veset e kohës. Ndoshta vetëm cigaren e teproi qe nuk e la dot kurrë , një shoqe e heshtur që e ndoqi deri në fund. Dhe një ditë, në heshtje, si një hije që rritet ngadalë mbi mal, një sëmundje e maskuar u fsheh në mushkëritë e tij. Një sëmundje e pashërueshme që e breu si tenja lisin. Ajo e rrëzoi në një kohë kur askush nuk e priste, përveç vetë Pëllumbit. Ai e kuptoi më herët se të tjerët. Dhe e priti fundin pa panik, me atë qetësinë e burrave që kanë jetuar drejt dhe nuk kanë frikë nga udha e fundit. Sot ai ka marrë rrugën drejt amshimit, duke lënë pas një kujtim të pastër si ujët e bjeshkëve të Dukagjinit. Sepse disa njerëz nuk bëjnë zhurmë në jetë, por lënë pas një heshtje të madhe kur largohen.Pushofsh në paqe, Pëllumb Sokoli! Sot ike bash në ditëlindjen tënde të 74-të. Ike i menduar, pa treguar se per ku je nisurUdhë të mbarë, Pëllumb. Atje ku po shkon ti ke me gjet babën Lulash ulë kambkryqme gjithë plisbardhët e Pepesumajve dhe të Mollës(.Lulash Vuksani, Dedë Lushi , Pjeter Koca,Ndue Biba,Bal Marku,Nikë Pali , Mehilli Nika,Mehill Kola, Mark Lule i,Gjon Kaceli, Lekë Vojvoda Pjeter Zogu,Fran Marku,Dedë Ndoci,Pal Bungu)Janë ma shumë se një tërvese burra emën-mëdhenj të Shoshit të vjetër. Qiti duhan e çmallu me ta, por mos u kallzo se Gjytetëzën, kullat e stanet e tyne i kemi lanë shkretë. Nana Sose ka me të përqafue e me të qortue: "Pse erdhe kaq shpejt, djalë të pastë lokja! Toma ka me të thanë:-"Vëlla, më kishte marrë malli." Nuni, me shpotinë e tij, ka me të thirr: "Kryetar, ku e ke brigadën gati për aksion?" Aty kanë me të dalë përpara: Zef Marashi, Marash Nika, Zef Lushi,Pjeter Biba Kolë Mehilli, Kol Lulashi, Gjon Shpatina, Mirash Zefi, Tomë Kola, Mark Ndoshi,Tomë Kaceli,Mark Bala, Ded Kola,Ndue Marku , Gjon Zefi, Vat Marku. Vat Nika ,Gjon Shani, Mehlll Pjetra Sadik Frani e Kin Qarrca . Me krahë hapun kanë me të pritë edhe moshatarët e lojërave rinore: Kolë Zefi, Nikoll Mehilli, Tom Geshtnja, Gjokë Kola, Lin Kola. E ti, Pëllumb, shko i qetë mes tyne, si një zog që kthehet në folenë e vjetër të shpirtit. Rri me burrat e Shoshit në sofrën e amshimit, ndezni duhanin e kujtimeve dhe lini që bisedat e heshtuna të ngjiten si tym i bardhë drejt qiellit. Pushofsh i qetë, Pëllumb, në dritën e pasosun të Amshimit, atje ku shpirtrat e mirë nuk ndahen kurrë nga njëri-tjetri.

PRELË MILANI

REDAKSIA
Kryeredaktore: Klodjana Serraj
Prele Milani, Lazer kodra, Lazer Stani, Roza Pjetri, Suela Ndoja, Zef Nika, Vuksan Kola, Zef Gjeta, Ledia Dushi, Leke Sokoli, Edmond Tërthorja, Lulash Brigja, Vilson Peshkaj, Prele Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziçi, Gasper Marku, Mark Gjeka.

MUNDËSOI BOTIMIN, BAR-RESTORANT "ORLANDO", ME PRESIDENT TOME ARRA